



Udhëzime të shkurtra
mbi hapat dhe

PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E PRODHIMEVE CILËSORE ME TREGUES GJEOGRAFIK DHE SPECIALITETEVE TRADICIONALE





Udhëzime të shkurtra mbi hapat dhe procedurat për

REGJISTRIMIN E PRODHIMEVE CILËSORE ME TREGUES GJEOGRAFIK DHE SPECIALITETEVE TRADICIONALE NË NIVEL TË BE-SË





CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

664:347.77(497-15)(083.131)

UDHËZIME të shkurtra mbi hapat dhe procedurat për regjistrimin e prodhimeve cilësore me tregues gjeografik dhe specialiteteve tradicionale në nivel të BE-SË / [redaktua nga Sonja Srbinovska dhe Paola Corsinovi]. - Shkup : Grupin e përhershëm të punës për zhvillimin rural rajonal, 2020. - 36 str. : ilustr. ; 21 cm

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4760-27-6

а) Прехрамбени производи - Ознаки на потекло - Географски поими - Земји од Западен Балкан - Упатства COBISS.MK-ID 112202506

Ky dokument është përpiluar në kuadër të programit rajonal “Mbështetje diversifikimit ekonomik të zonave rurale në Evropën Juglindore (SEDRA)”, i miratuar nga Ministria Federale Gjermane për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (BMZ) dhe i implementuar nga Grupi Permanent i Punës për Zhvillim Rajonal në EJL (SWG) dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

U redaktua nga Sonja Srbinovska dhe Paola Corsinovi me kontribut të Vlado Kovacevic dhe Veli Hoti, si dhe në bashkëpunim me ministritë e bujqësisë së vendeve/territoreve të EJL-së.

TABELA E PËRMBAJTJEVE

1. PARATHËNIE DHE KOMENTE TË PËRGJITHSHME.....	5
1.1 Mbrojtja që caktohet nga regjistrimi.....	8
2. PROCESI I REGJISTRIMIT: procedurat kryesore.....	9
2.1 Çështjet kryesore.....	9
2.2 Kërkesa e aplikimit: procedura në nivel kombëtar	9
2.3 Kërkesa e aplikimit: procedura në nivel të BE-së (për vendet e BE-së).....	10
2.4 Kërkesa e aplikimit: procedura për vendet e treta.....	11
3. PËRMBAJTJA e APLIKACIONIT për REGJISTRIM.....	13
3.1 Dosja e aplikacionit: disa shpjegime.....	15
3.1.1 Emri dhe Adresa e Grupit të Aplikantëve.....	15
3.1.2 Emri dhe Adresa e Autoriteteve	15
3.1.3 Emri dhe adresa e organeve që e verifikojnë pajtueshmërinë e dispozitave për specifikacionin e produktit.....	18
4. SPECIFIKACIONI I PRODUKTIT	18
4.1 Emërtimi i produktit (emri i produktit).....	18
4.2 Përshkrimi i produktit (lënda e parë dhe karakteristikat kryesore).....	19
4.3 Përkufizimi i zonës gjeografike të përcaktuar	21
4.4 Prova që produkti e ka origjinën prej zonës së përcaktuar gjeografike	22
4.5 Përshkrimi i metodës së sigurimit të produktit.....	23
4.6 Përmendja e organit të kontrollit të cilësisë.....	26
4.7 Rregullat konkrete lidhur me etiketimin në lidhje me shkurtimet PDO/PGI.....	26
4.8 Rregullat dhe kushtet në pajtim me dispozitat kombëtare dhe të BE-së.....	27
5. DOKUMENTI I VETËM.....	28
6. SPECIALITETE TRADICIONALE TË GARANTUARA (TSG).....	34
6.1 Përmbajtja e aplikacionit për regjistrim të TSG-së	34
6.2 Kriteret kryesore për regjistrim të TSG-së.....	34
6.3 Specifikacioni i produktit (TSG)	35
7. SKEMA SHITESË E CILËSISË.....	35
KONKLuzionet dhe komentet përfundimtare.....	36



Heqja e përgjegjesisë (disclaimer):

Ky dokument iu dedikohet aplikantëve, të cilët dëshirojnë ta regjistrojnë emrin e një produkti bujqësor ose ushqimor si një PDO (Përcaktimi i mbrojtur i origjinës (ang. protected designation of origin)) ose PGI (Treguesi gjeografik i mbrojtur (ang. protected geographical indication)) ose TSG (Specialitete tradicionale të garantuara (ang. traditional specialties guaranteed) në kuadër të BE-së. Ky dokument shërben vetëm për çështje informimi. Ai nuk ka as vlerë juridike as interpretative dhe nuk i zëvendëson, ndryshon ose modifikon rregullat e përcaktuara nga legjislacioni përkatës. Rezultatet e paraqitura këtu shërbejnë vetëm për qëllime informuese (jo reklamimi), ndërsa përmbajtjet janë grumbulluar nga uebfaqe individuale.

1. KOMENTE TË PËRGGJITHSHME mbi SKEMAT E CILËSISË

Politikat e Bashkimit Europian (BE) mbi cilësinë synojnë të mbrojnë emrat e produkteve specifike për të promovuar karakteristikat e tyre unike, si dhe njohurinë dhe ekspertizën tradicionale. Janë identifikuar tre skema të cilësisë së bashku me shkurtimet e tyre PDO (Përcaktimi i mbrojtur i origjinës (ang. protected designation of origin)) ose PGI (Treguesi gjeografik i mbrojtur (ang. protected geographical indication)) ose TSG (Specialitete tradicionale të garantuara (ang. traditional specialties guaranteed)). Këto skema i promovojnë dhe i mbrojnë emrat e produkteve bujqësore cilësore dhe artikujve ushqimor, si dhe nxisin prodhim bujqësor të diversifikuar, i mbrojnë emrat e produkteve nga, mes tjerash, keqpërdorimi, evokimi dhe imitimi, si dhe iu ndihmojnë konsumatorëve duke iu siguruar informacione rreth karakterit specifik të produktit (Komisioni Evropian, 2012) (Figura 1).

PDO dhe PGI njihen si Tregues Gjeografik (GI) për shkak të lidhjes specifike me një zonë në të cilën janë prodhuar. Identifikimi GI i mundëson konsumatorët të kenë besim dhe të dallojnë produktet cilësore, ndërsa njëkohësisht i ndihmon prodhuesit të shesin produktet e tyre në treg më mirë. E drejta për Treguesin Gjeografik iu mundëson atyre të cilën kanë të drejtë të shfrytëzojnë treguesin për të parandaluar shfrytëzimin e tij nga palë të treta, produkti i të cilëve nuk është në përputhshmëri me standardet e aplikueshme TSG e thekson karakterin tradicional të produkteve, ose rreth përbërjes së tyre ose mënyrës së prodhimit, dhe prandaj nuk i referohet vetëm origjinës gjeografike (Komisioni Evropian, 2012).

Skemat e cilësisë së Bashkimit Europian:



Përcaktimi i mbrojtur i origjinës (ang. Protected Designations of Origin-PDO), janë emra që përdoren për të treguar një produkt i cili po ashtu e ka origjinën nga një territor i kufizuar (rajon, lokalitet ose një shtet) cilësia ose karakteristikat e të cilit janë thelbësore ose ekskluzive për shkak të origjinës së tij. Fak-

torët natyrorë dhe njerëzor të një territori shpeshherë janë meritë për atë cilësi të dalluar. Për një PDO, të gjitha hapat e prodhimit të produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimor duhet të kenë origjinën nga i njëjti rajon. Kjo nënkupton që lënda e parë për një produkt të transformuar PDO (për shembull, qumështi për produktin e djathit) duhet ta ketë origjinën nga i njëjti rajon gjeografik.



Treguesi gjeografik i mbrojtur (ang. Protected Geographical Indication-PGI), janë emra që tregojnë për origjinën e një produkti nga një territor i caktuar (lokalitet, rajon ose një shtet) të cilit mund t'i atributohet një cilësi e caktuar, reputacion ose karakteristika të tjera që kanë të bëjnë me origjinën e tij. Së paku një nga hapat e prodhimit duhet të ndodh në territorin e caktuar, që nënkupton se lënda e parë për të prodhuar produktin nuk duhet domosdoshmërisht të ketë origjinën e rajonit gjeografik të caktuar.



Me termin Specialitete tradicionale të garantuara (ang. Traditional Specialties guaranteed (TSG), Bashkimi Europian thekson aspektin tradicional siç është mënyra e produktit ose përbërja e tij, pa mos e ndërlidhur me një zonë të caktuar gjeografike. Emri i produktit që regjistrohet si një TSG e mbron atë nga falsifikimi dhe keqpërdorimi.

Burimi: https://ec.europa.eu/info/food-farming-fisheries/food-safety-and-quality/certification/quality-labels/quality-schemes-explained_en



Si pjesë përbërëse e sistemit të BE-së të të drejtave të pronës intelektuale (IPRs), emrat e produkteve të regjistruara si GI janë të mbrojtur ligjërisht kundër imitimeve dhe keqpërdorimit brenda BE-së dhe në vendet jashtë BE-së, me të cilat është nënshkruar ndonjë marrëveshje konkrete për mbrojtje të tillë.¹

GI-të përfaqësojnë më tepër sesa një sistem për theksimin e emrit gjeografik. Ato identifikojnë një produkt ashtu sikur origjinon nga një territor i caktuar, ku një ose më tepër karakteristika të tij, si dhe cilësia, reputacioni ose disa tipare unike të tija – i atribuohen origjinës së tij gjeografike, si dhe faktorëve të caktuar njerëzor dhe natyror që gjenden në atë rajon. Sipas shumë publikimeve shkencore, GI-të (Treguesit Gjeografik) mund të paraqesin një mundësi të rëndësishme që shumë rajone të shtojnë vlerën në ekonomitë dhe shoqëritë e tyre, jo vetëm në kuptimin e tregtisë dhe të ardhurave, por edhe në kuptimin e përfitimeve kulturore dhe mjedisore. Kjo premisë bazohet, pjesërisht, në suksesin e jashtëzakonshëm të GI-ve në rajonet dhe shtetet siç janë Franca, Italia (ITC, 2009)².

Pasi që Marrëveshja e Organizatës Botërore të Tregtisë mbi Pikëpamjet lidhur me Tregtinë e të Drejtave të Pronësive Intelektuale (ang.TRIPS) hyri në fuqi në mesin e viteve të '90-ta, kushtet e GI-ve po ashtu janë futur në përdorim. Marrëveshja TRIPS, Neni 22, paragrafi 1 e përmban përshkrimin vijues për GI-të:

"[...] Tregues që e identifikojnë një mall se e ka prejardhjen nga territori i një Vendi Anëtar, ose rajoni ose lokaliteti në atë territor, ku cilësia, reputacioni ose një tipar tjetër i mallit i atribuohet origjinës gjeografike të atij malli".

¹ Të drejtat e pronës intelektuale (IPR) i mbrojnë asetet e jotrupëzuara të një kompanie, duke iu mundësuar kompanive të kenë profit nga aktivitetet e tyre kreative dhe mjaft novatore. Asetet e jotrupëzuara llogariten për më tepër se gjysma e vlerës së kompanisë, ndërsa rëndësia e tyre është gjithnjë në rritje. Në një botë ku kompanitë e BE-së garojnë më shumë në fushën e novacionit, kreativitetit dhe cilësisë se sa në çmim, pronësia intelektuale paraqet një vegël të fuqishme për sipërmarrjet e BE-së që të bëhen edhe më konkurrues. Komisioni ka hartuar një kuadër ligjor dhe një sistem mbi pronësinë intelektuale që iu ofron lehtësime kompanive të BE-së për të investuar në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve të cilësisë së lartë, novacione, dizajn dhe kreativitet.

² https://www.origin-gi.com/images/stories/PDFs/English/E-Library/geographical_indications.pdf

³ Rregullativa (EU) Nr. 1308/2013 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 17 dhjetor 2013 që themelon organizim të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore, me të cilën shfuqizohet Rregullativat e Këshillit (EEC) Nr. 922/72, (EEC) Nr. 234/79, (EC) Nr. 1037/2001 dhe (EC) Nr. 1234/2007 dhe Rregullativën e Deleguar të Komisionit (EU) 2019/33 të datës 17 tetor 2018, rregullativën plotësuese (EU) Nr. 1308/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian lidhur me zbatimin e rregullativës për mbrojtje të emërtimeve të origjinës, treguesve gjeografik dhe termave tradicional në sektorin e verës, procedurën e kundërshtimit/ankesave, kufizimit të përdorimit, ndryshimeve të specifikacionit të produktit, anulimin e mbrojtjes, si dhe etiketimin dhe paraqitjen.

⁴ Rregullativa (EU) Nr. 251/2014 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 26 shkurt 2014 mbi përkufizimin, përshkrimin, paraqitjen, etiketimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografik të produkteve të verës së aromatizuar dhe shfuqizimin e Rregullativës së Këshillit (EEC) Nr. 1601/91

⁵ Rregullativa (EU) 2019/787 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 17 prill 2019 mbi përkufizimin, përshkrimin, paraqitjen dhe etiketimin e pijeve alkoolike, përdorimin e emrave të pijeve alkoolike në paraqitjen dhe etiketimin e artikujve ushqimor, mbrojtjen e treguesve gjeografik për pjetet alkoolike, përdorimin e alkoolit etilik dhe distillateve në produktet me origjinë bujqësore të pijeve alkoolike, si dhe shfuqizimin e Rregullativës (EC) Nr. 110/2008

⁶ Rregullativa e Deleguar e Komisionit (EU) Nr. 664/2014 të datës 18 dhjetor 2013 që e plotëson Rregullativën (EU) Nr. 1151/2012 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian lidhur me themelimin e simboleve të Unionit për emërtimet e mbrojtura të origjinës, treguesve të mbrojtur gjeografik dhe specialiteteve tradicionale të garantuara dhe në lidhje me disa rregulla mbi furnizimin, rregulla të caktuara procedurale dhe disa rregulla të tjera kalimtare

⁷ Rregullativa Implementuese e Komisionit (EU) Nr. 668/2014 e datës 13 qershor 2014 që i përcakton rregullat e zbatimit të Rregullativës (EU) Nr. 1151/2012 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian mbi skemat e cilësisë të produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimor.

Në kuadër të BE-së, GI-të janë rregulluar me disa Rregullativa varësisht nga lloji i produktit të caktuar: produkte bujqësore dhe artikuj ushqimor, ose verëra, ose alkool, ose artizanate ose produkte industriale.

Në të gjitha rastet, Vendet Anëtare janë përgjegjëse për të parandaluar përdorimin joligjor të treguesve gjeografik të mbrojtur brenda BE-së. Rregullativa vijuese e BE-së është në fuqi për momentin:

- Rregullativa (EC) Nr. 1151/2012 mbi mbrojtjen e treguesve gjeografik të produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimor
- Rregullativa (EC) Nr. 1308/2013 mbi mbrojtjen e treguesve gjeografik të verës³
- Rregullativa (EC) N.r 251/2014 mbi mbrojtjen e treguesve gjeografik të verës së aromatizuar⁴
- Rregullativa (EC) Nr. 110/2008 mbi mbrojtjen e treguesve gjeografik të pijeve alkoolike⁵

Janë përcaktuar edhe rregulla dhe dispozita tjera në Rregullativën e Deleguar të Komisionit (BE) Nr. 664/2014⁶ dhe Rregullativën Implementuese të Komisionit (BE) Nr. 668/2014⁷.

Rregullativa 1151/2012 vlen vetëm për disa produkte bujqësore dhe artikuj ushqimor, për shembull, për frutat dhe perimet, peshkun, mishin dhe prodhimet e mishit, djathin, bukën, parori ose birra. Klasifikimi në Shtojcën XI të Rregullativës Implementuese përmban një listë gjithëpërfshirëse.

(Tabela 1 ofron një listë të shkurtër sipas rregullativës së BE-së).

Tabela 1. Lista dhe klasifikimi i produkteve

Produkte bujqësore të destinuara për konsum njerëzor, të cilat mund të mbrohen	Nga Klasi 1.1. deri 1.8 Mishi i freskët (dhe rropulli); Produktet e mishit (të gatuar, të kripur, të tymosur, etj.); Djathërat; Produkte të tjera të prejardhjes shtazore (vezë, mjaltë, bylmetë, përveç gjalpës, etj.); Vajra dhe yndyra (gjalpë, margarnë, vaj, etj.); Fruta, perime dhe drithëra, të freskëta ose të përpunuara; Peshk të pastër, molusqe, krustaqe dhe produkte që rrjedhin prej tyre; produkte të tjera të specifikuara në Shtojcën I të Traktatit (erëza, etj.).
Produkte bujqësore dhe artikuj ushqimor që mund të mbrohen me PDO/PGI	Nga Klasi 2.1. deri 2.20 Birra, çokollata dhe prodhimet e tyre; buka, parori, embëlsira, kek, biskota dhe prodhime të tjera nga furrtari; pije të prodhuara nga ekstraktet bimore; pasta; kripë; mishra dhe rrëshira natyrore; pastë mustarde; bar; vajra thelbësore; tapë (etj.)
Specialitete tradicionale të garantuara	Nga Klasi 2.21. deri 2.27 ushqimet e përgatitura; <i>çokollatë dhe produktet e saj</i> ; bukë, parori, kek, embëlsira, biskota dhe prodhime të tjera nga furrtari; pije të prodhuara nga ekstraktet bimore; pasta; kripë.

Burimi: Lista e vetë autorit në bazë të Rregullativës 1151/2012 dhe 668/2014.

Rregullativa mbi produktet bujqësore ose artikujt ushqimor me emërtime GI përcakton që çdo kufizim mbi origjinën e lëndës së parë për GI duhet të arsyetohet duke pasur lidhje ndërmjet cilësisë specifike, reputacionit ose një karakteristike tjetër të produktit bujqësor ose artikullit ushqimor, si origjinën gjeografike.

Disa emra të caktuara tradicionale gjeografike dhe jo-gjeografike mund po ashtu të konsiderohen si emërtime të origjinës ose tregues gjeografik. Kjo lidhje duhet që konkretisht të jetë e afërt për produktet që të kualifikohen me etiketën "emërtimi i origjinës": cilësia ose karakteristikat e një produkti duhet të jenë thelbësore ose ekskluzivisht të një mjedisi të caktuar gjeografik duke i përfshirë dhe faktorët njerëzor dhe natyror të tij, ndërsa prodhimi, përpunimi dhe përgatitja duhet të ndodhin në një zonë të përcaktuar gjeografike. Kjo nënkupton që të gjitha fazat e prodhimit duhet të realizohen në atë zonë.

Për një "tregues gjeografik", mjafton që njëra fazë e prodhimit, për shembull, përpunimi të ndodh në zonën e përcaktuar gjeografike, ndërsa një cilësi e caktuar, reputacioni ose tipare të tjera të produktit të rezultojnë nga origjina gjeografike.

Në rastin e produkteve bujqësore ose artikujve ushqimor PGI, lënda e parë mund të sigurohet nga jashta zonës së përcaktuar gjeografike, përfshi dhe territorin e një vendi tjetër. Rregullativa e KE-së mbi produktet bujqësore ose artikujt ushqimor përcakton se çdo kufizim të origjinës së lëndës së parë për një produkt GI duhet të arsyetohet lidhur me lidhjen ndërmjet cilësisë së caktuar, reputacionit ose tipareve të tjera të një produkti gjeografik ose artikujve ushqimor dhe origjinës gjeografike.

Për shkak të ndërlukeshmërisë së sektorit të verës në BE, Rregullativa (EC) Nr. 1308/2012 mbi mbrojtjen e treguesve gjeografik të verës e përcakton specifikacionin e mëposhtëm:

- "**Emërtimi i origjinës**" nënkupton emrin e rajonit, një vend të caktuar ose një shtet që përdoret për të përshkruar një produkt që është në pajtim me kushtet vijuese:

- Cilësia dhe tiparet specifik janë ekskluzivisht për shkak të një mjedisi të caktuar gjeografik duke i përfshirë faktorët njerëzor dhe natyror të atij produkti;
- Rrushi nga i cili prodhohet produkti origjinon ekskluzivisht nga ai rajon gjeografik;
- Prodhimi i tij ndodh në këtë zonë gjeografike;
- Sigurohet nga varietetet e verës që i përkasin Vitis;

- "**Treguesi gjeografik**" nënkupton një tregues që i referohet një rajoni, një vendi konkret ose një shteti, që përdoret për të përshkruar që është në pajtim me kushtet vijuese:

- Posedon një cilësi të caktuar, reputacion ose tipare të tjera që i atribuohen atij Rajoni Gjeografik;
- Së paku 85 % e rrushit që përdoret për prodhimin e tij e ka prejardhjen nga ai rajon gjeografik;
- Prodhimi i tij ndodh në këtë zonë/rajon gjeografik;
- Sigurohet nga varietetet e verës që i përkasin Vitis vinifera ose një gërshetimi ndërmjet varieteteve Vitis vinifera dhe specieve të tjera të genus Vitis.



Në bazë të shumë publikimeve shkencore, Treguesit Gjeografik mund të paraqesin një mundësi të rëndësishme për shumë rajone për të shtuar vlerë në ekonominë dhe shoqëritë e tyre, jo vetëm vetëm në kuptimin e tregtisë dhe të ardhurave, por edhe në formë të përfitimeve kulturore dhe mjedisore. Kjo premise bazohet, pjesërisht, në suksesin e jashtëzakonshëm të GI-ve në rajone dhe shtete siç janë Franca dhe Italia (ITC, 2009)⁸. GI-të janë shumë më tepër se sa një sistem për shënimin e emrave gjeografik. Ato identifikojnë një produkt që vjen nga një territor i caktuar, ku një ose më tepër karakteristika të tij dhe cilësia e tij, reputacioni ose disa karakteristika tjera unike – thelbësisht i atributohen origjinës së tij gjeografike dhe faktorëve të caktuar njerëzor ose natyror që gjenden në atë rajon.

Me qëllim që të kuptojmë sistemin e ndërlikuar të GI-ve (PDO dhe PGI, si dhe regjistrimin e tyre dhe njohjen në nivel të BE-së, ky dokument është përgatitur dhe disenjuar për aplikantët dhe palët e interesuara në zhvillimin dhe regjistrimin e produkteve të tyre GI.

Ky dokument siguron disa udhëzime të shkurtra mbi hapat dhe procedurat e regjistrimit të produkteve me Tregues Gjeografik (PDO dhe PGI) dhe Specialiteteve Tradicionale. Me qëllim kuptimin e asaj se si zbatohen disa kushte të BE-së në vendet më të suksesshme të BE-se, disa GI italiane janë marr si shembull.

⁸ https://www.origin-gi.com/images/stories/PDFs/English/E-Library/geographical_indications.pdf

1.1 Mbrojtja që caktohet nga regjistrimi

Të gjithë prodhuesit që janë në pajtim me specifikacionin korrespondues mund të shfrytëzojnë një regjistër emrash në bazë të Rregullativës së BE-së. Simbolet e BE-së (logot) patjetër duhet të paraqiten në etiketën e produkteve që origjinojnë në Bashkimin Europian dhe shiten në treg sipas emrit të regjistruar. Mund të përdoren nocionet "treguesit e mbrojtjes së origjinës" ose "treguesi gjeografik i mbrojtur" ose shkurtime të përkatëse "PDO" ose "PGI" (Neni 12(3) i Rregullativës).

Organet e kontrollit në kuadër të vendeve anëtare e verifikojnë pajtueshmërinë me specifikacionin. *Çdo prodhues i një produkti përkatës duhet t'i përmbahet sistemit të kontrollit (bazuar në pagesë).*

Shfrytëzimi i emrave të mbrojtur për produktet e krahasueshme që kanë një origjinë të ndryshme ose veçori të tjera nuk janë të pranueshme. Shfrytëzimi i emrit të regjistruar për produkte të tjera po ashtu është e ndaluar, nëse me këtë gjë po eksploatohet reputacioni i produktit të mbrojtur. Për më tepër, Rregullativa i mbron në mënyrë gjithëpërfshirëse emrat e regjistruara e të mbrojtura kundër çfarëdo keqpërdorimi, imitimi, evokimi edhe nëse origjina e produktit është treguar ose emri i mbrojtur është përkthyer ose shoqëruar me një shprehje si p.sh. "stil", "tip", "metodë", "sikur është prodhuar në", "imitim" ose ngjashëm, si dhe çfarëdo praktika tjera çorientuese. Për më tepër, emrat e mbrojtur nuk mund të bëhen gjenerik (Neni 13(1) dhe (2) i Rregullativës).

Regjistrimi i treguesve të origjinës gjeografike nuk i prek të drejtat e përcaktuara nga markat e mëhershme tregtare të fituara në mirëbesim. Mirëpo, bashkëjeteja e markave tregtare dhe e treguesit të origjinës ose treguesit gjeografik patjetër duhet të tolerohet. Nga ana tjetër, marka e mëvonshme tregtare nuk mund të mbrohet nëse aplikacioni është depozituar në lidhje me produkte të krahasueshme dhe nëse përdorimi i markës tregtare do të ishte në kundërshtim me Nenin 13 të Rregullativës (Neni 14 i Rregullativës).

2. PROCESI I REGJISTRIMIT: procedurat kryesore

2.1 Çësthjet kryesore

Procesi i aplikimit ndodh në procedurë dy nivelesh: në nivel kombëtar dhe nivel të BE-së.

Aktorët kryesorë të përfshirë në këtë procedurë janë aplikantët (grupi i prodhuesve) dhe autoritetet kombëtare (dhe europiane) të ngarkuar për regjistrimin. Grupi i prodhuesve të interesuar në aplikimin për regjistrim të një emri evropian GI në kuadër të BE-së patjetër duhet të ndjek procedurën që përfshin dy faza, njëra në nivel kombëtar dhe tjetra në nivel evropian.

Çdo prodhues ose grup prodhuesish në një zonë gjeografike lidhur me emërtimin PDO/PGI ka të drejtë të përdor emrin e regjistruar për të futur në treg produktin përkatës, përderisa respektohen kushtet e prodhimit të përcaktuara në specifikacionin e produktit.

Kjo është një arsye pse aplikacionet në përgjithësi depozitohen nga grupe prodhuesish, e cila gjë natyrisht i përfaqëson të gjithë prodhuesit e përfshirë të një zone.

Me qëllim që të regjistrohet një GI, produkti duhet t'i përmbahet specifikacionit të detajuar, përfshi së paku lëndën e parë dhe karakteristikat kryesore fizike, kimike, mikrobiologjike ose organoleptike të produktit.

Duhet të sigurohet dëshmi për zonën gjeografike, së bashku me metodën e prodhimit, dhe të gjitha këto elemente të demonstrojnë që produkti e ka origjinën nga zona e përcaktuar gjeografike dhe se është në përputhje me metodën e etiketimit.

Të gjitha dokumentet që i dërgohen Komisionit Evropian duhet të jenë në një nga gjuhët zyrtare të institucioneve të Bashkimit Evropian ose të shoqërohen me përkthim të certifikuar në njërin nga ato gjuhë.

2.2 Kushtet e aplikimit: procedura në nivel kombëtar

Procedura në nivel kombëtar për vendet anëtare të BE-së i përmban hapat vijues:

- Përcaktimi i grupit të prodhuesve për produktin e tyre sipas specifikacionit të përpiktë (shih faqet e mëposhtme)
- Kërkesa e grupit të prodhuesve e depozituar autoriteteve kompetente kombëtare
- Shqyrtimi i aplikacionit nga autoritetet kombëtare për të vërtetuar nëse është e justifikuar dhe nëse i përmbush kushtet e legjislacionit (rregullativën e BE dhe ligjet kombëtare)
- Procedura ankimore (*çdo person që ka interes legjitim dhe është rezident i territorit të vet mund të dorëzojë ankesë kundër aplikacionit*).

Për produktet jo të BE-së, të cilat dëshirojnë të regjistrohen në nivel të BE-së, prodhuesit ia dërgojnë Komisionit Evropian aplikacionet e tyre drejtpërdrejtë ose nëpërmjet autoriteteve kombëtare. Megjithatë, aplikacionet duhet t'i dorëzohen Komisionit drejtpërdrejtë nga prodhuesit – nuk është e detyrueshme që ato të dërgohen nëpërmjet autoriteteve kombëtare.⁹

Aplikacionet e përbashkëta, siç iu referohet në Rregullativën (BE) Nr. 1151/2012 do t'i depozitohen Komisionit nga një Vend Anëtar përkatës ose nga një grup aplikantësh së një vendi të tretë, drejtpërdrejtë ose nëpërmjet autoriteteve të atij vendi të tretë. Aplikacioni duhet të përfshijë deklaratën e të gjitha Vendeve Anëtare të përfshira. Kushtet e përcaktuara në Nenin 8 dhe 20 të Rregullativës (BE) Nr. 1151/2012 duhet të përmbushen nga të gjitha Vendet Anëtare dhe vendet e treta në fjalë.

Për shembull:

Për secilin vend të Ballkanit Perëndimor ekzistojnë procedura ligjore për mbrojtje në bazë të rregullativës së harmonizuar kombëtare ose skemave për cilësi (Ju lutemi ndiqni udhëzimet kombëtare/shtetërore për mbrojtje).

Për të regjistruar emrin e produktit, prodhuesit ose grupet e prodhuesve duhet të paraqesin specifikacionet e produktit, ndërsa aplikacioni i dërgohet për shqyrtim autoriteteve kombëtare. Pas miratimit të

⁹ Në rast të aplikacioneve nga vendet e treta, nuk është e nevojshme që së pari të merret statusi i mbrojtur si GI nga vendi i origjinës – BE-ja kërkon provë që emri është i mbrojtur, por gjithashtu mund të jetë i mbrojtur si markë tregtare.



mbrojtjes në vendin e vet, grupi mund t'ia dërgojë aplikacionin Komisionit Europian, i cili do ta shqyrtojë kërkesën.

Autoritetet kombëtare kontrollojnë nëse aplikacioni i përmbush kushtet e rregullativës, si dhe verifikohet përshtatshmëria e regjistrimit të emrit si një tregues i mbrojtur gjeografik ose emërtim i mbrojtur. Nëse nuk është i përshtatshëm, atëherë aplikantët njoftohen për këtë vendim negativ dhe aplikacioni nuk kalon më tej.

Në qoftë se aplikacioni i depozituar nga një grup aplikantësh i plotëson kushtet dhe kualifikohet për të marrë një vendim të favorshëm, atëherë ai aplikacion mund t'i përcjell Komisionit Evropian për një shqyrtim plotësues të aplikacionit.

Si pjesë përbërëse të shqyrtimit, autoritetet kombëtare do të nisin një procedurë kombëtare të kundërshtimit që siguron publikim adekuat të aplikacionit dhe që siguron një periudhë të arsyeshme brenda të cilës çdo person fizik ose juridik që ka interesim legjitim ose është resident në atë territor mund të dorëzojë kundërshtim ndaj aplikacionit. Pranueshmëria e kundërshtimeve të pranuar duhet të shqyrtohet dhe nëse kushtet e kësaj Rregullative konsiderohet se janë plotësuar, atëherë mund të merret një vendim i favorshëm dhe të dorëzohet dosja e aplikacionit tek Komisioni. Në raste të tilla, Komisioni do të njoftohet për kundërshtimet e pranuar e të miratuara.

Në kuadër të fushëveprimit të shqyrtimit të aplikacionit, **Autoritetet Kompetente Kombëtare (AKK)** kërkon nga organet eksperte që të japin mendime dhe nëse të gjitha kushtet përmbushen, e **publikon aplikacionin**. Kjo nënkupton që AKK-ja do të ngrit një procedurë kombëtare të kundërshtimit që siguron publikim adekuat të aplikacionit. *Çdo person që ka interes legjitim, banor i shtetit, mund të parashtojë kundërshtim* ndaj aplikacionit para AKK-së **brenda një-dy muajve (në përputhje me ligjet kombëtare)**, pas publikimit. AKK-ja duhet të shqyrtojë pranueshmërinë e kundërshtimeve të pranuar sipas skemave PDO, PGI ose TSG.

Në qoftë se, pas vlerësimit të kundërshtimeve të pranuar, AKK-ja konsideron që kushtet e Rregullativës janë përmbushur, atëherë ai mer vendim pozitiv dhe e mbron atë emërtim në vendin përkatës, i cili po ashtu duhet të publikohet në Gazetën Zyrtare kombëtare dhe e dërgon emrin e produktit tek Regjistri zyrtar i emërtimeve të produkteve (PDO, PGI ose TSG). Nëse specifikacioni ka qenë shumë i ndryshuar pas publi-

kimit të aplikacionit, këto ndryshime duhet të publikohen së bashku me vendimin e favorshëm. *Çdo prodhues i grupit duhet të dëshmojë prodhimin e tij në bazë të specifikacionit të produktit nëpërmjet organeve kombëtare kompetente të kontrollit dhe pastaj mund të futen në Regjistrin e prodhuesve.*

Në qoftë se një grup prodhuesish aplikon për të regjistruar një emër që e përfaqëson një zonë gjeografike kufitare ose një emër tradicional lidhur me atë zonë gjeografike, por që gjendet në një shtet tjetër, autoritetet kombëtare duhet të këshillohen me autoritetet përkatëse të atij shteti para se t'ia depozitoj aplikacionin Komisionit.

Kjo dispozitë synon të konstatoj nëse një produkt po prodhohet diku tjetër me emër të njëjtë, në të dyja anët e kufirit, si dhe përpiqet të gjejë një zgjidhje të përgjithshme për problemin. Për shembull, njëra zgjidhje do të përbënte krijimin e një specifikacioni të përbashkët dhe një aplikacioni të përbashkët me shtetin e tretë ose me Vendin Anëtar në fjalë. Në këtë rast, prodhuesit do të jenë në gjendje të ruajnë të drejtat e tyre për emrin edhe nëse ato paraqesin minoritet të prodhuesve që gjenden në një shtet ndryshe nga ajo ku gjendet shumica e prodhuesve.

2.3 Kushtet e aplikimit: procedura në nivel të BE-së

Pas pranimit të dokumentacionit nga Vendet Anëtare, Komisioni e shqyrton aplikacionin.

Komisioni do të shqyrtojë, me çdo kusht, çdo aplikacion që të verifikojë nëse është i justifikuar dhe nëse i plotëson kushtet e skemës përkatëse Ky shqyrtim nuk duhet të tejkalojë periudhën prej gjashtë muajve. Komisioni, së paku çdo muaj, do të publikojë listën e emrave që janë paraqitur për regjistrim, si dhe datën e dorëzimit të tyre.

Në qoftë se Komisioni konsideron që kushtet e përcaktuara në Rregullativën 1151/2012 ose Rregullativën 1308/2013 (për verëra) janë përmbushur, atëherë ai e publikon atë në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian, si dhe Dokumentin e Vetëm të aplikacionit dhe referencën për publikimin e specifikacionit (Vendet anëtare duhet të sigurojnë qasje elektronike në publikimin e specifikacionit). Aty ku nuk ndodh kështu, Komisioni e hedh poshtë aplikacionin e regjistrimit. Publikimi hap një periudhë kundërshtimesh gjatë së cilit çdo Vend anëtar ose vend i tretë mund ta kundër-

shtojë regjistrimin, duke i dërguar një deklaratë të vërtetuar siç duhet Komisionit. Në qoftë se nuk ka kundërshtime, atëherë emri regjistrohet dhe futet në Regjistrin europian të Treguesve Gjeografik të Mbrojtur dhe Emërtimeve dhe Bazat e të Dhënave të Origjinës dhe publikohet në OJEU (Fletorja zyrtare e BE-së).

Çdo shtet tjetër anëtar ose vend i tretë, si dhe të gjithë personat që shprehin interesim legjitim, të etabluar ose janë rezident në një vend tjetër anëtar ose vend të tretë, mund të depozitojë një kundërshtim ndaj regjistrimit të propozuar.

Kundërshtimet mund të bazohen vetëm në arsyet e përcaktuara në Nenin 10(1) të Rregullativës, në fakt:

- a) Kushtet e referuara të Nenit 5 të Rregullativës për emërtimet e origjinës ose treguesit gjeografik ose kushtet e referuara të Nenit 7(1) të Rregullativës për specifikacionet nuk janë të respektuara.
- b) Emri i propozuar bie ndesh me emrin e një varieteti bimësh ose një racë kafshësh ose me një emër të regjistruar ose me një markë të njohur tregtare në përputhje me Nenin 6(2), (3) ose (4) të Rregullativës.
- c) Regjistrimi i emrit të propozuar mund të rrezikojë ekzistencën e një emri ose marke tregtar që është plotësisht ose pjesërisht homonime ose ekzistencën e produkteve që janë në treg ligjërish për së paku pesë vite para datës së publikimit sipas Nenit 50(2)(a) të Rregullativës;
- d) Emri që kërkohet për regjistrim është emër gjenerik.

Në qoftë se deklarimi i arsyetuar i kundërshtimit është i pranueshëm, atëherë Komisioni do të ftojë të gjitha palët e interesuara, në hapin e parë, për të arritur marrëveshje. Në qoftë se nuk arrihet marrëveshje, Komisioni do të merr vendim, në kuadër të procedurës së komisionit, nëse duhet emri të hyjë ose jo në regjistrin e emrave të mbrojtur.

Komisioni mund të anulojë çdo regjistrim me iniciativë të vet ose me kërkesë të një vendi anëtar ose me kërkesë të çdo personi fizik ose juridik me interesim legjitim, në qoftë se kushtet e specifikacionit për një produkt bujqësor ose artikull ushqimor, të mbuluar me një emër të mbrojtur, nuk plotësohen më ose nëse nuk është futur në treg asnjë produkt sipas emërimit të mbrojtur të origjinës ose treguesit të mbrojtur gjeografik gjatë shtatë viteve të fundit (Neni 54 i Rregullativës).

2.4 Kushtet e aplikimit: procedura për vendet e treta

Vendet e treta i regjistrojnë GI-të e tyre në BE. BE-ja e ofron nivelin e njëjtë të mbrojtjes për GI-të e BE-së dhe ato që nuk janë të BE-së. Dallimi i vetëm lidhur me produktet GI të BE-së është se aplikacionet mund t'i dërgohen drejtpërdrejtë Komisionit nga vendi aplikant ose nëpërmjet autoriteteve kompetente përkatëse të vendit të tretë në fjalë. I tërë dokumentacioni që i dërgohet Komisionit duhet të jetë në njërin nga gjuhët zyrtare të institucioneve të Bashkimit Europian ose të shoqërohet me përkthim të certifikuar në njërin nga ato gjuhë.

Dosja e aplikacionit që aplikanti ia dërgon Komisionit i përmban informacionet e listuara në pjesën 3 të këtij dokumenti.

- (1) Specifikacionin dhe informacionet shoqëruese (informacione rreth grupit të aplikantëve; provë të mbrojtjes nga vendi i origjinës).
- (2) Dokumentin e Vetëm. Nëse pranohet aplikacioni, kjo do të publikohet në Gazetën Zyrtare të BE-së.

Mirëpo, aplikacioni duhet të përfshijë deklaratën e AKK-së, në të cilën konsideron që aplikacioni i dorëzuar nga grupi i aplikantëve është kualifikuar për vendim të favorshëm dhe i përmbush kushtet e Rregullativës, si dhe dispozitata e miratuara në bazë të tyre.

Në qoftë se aplikacioni i dorëzohet Komisionit në formë të dosjes së aplikimit, AKK-ja duhet ta informojë Komisionin për kundërshtimet e pranuar nga persona juridik dhe fizik, të cilët në mënyrë ligjore i kanë futur në treg produktet në fjalë, duke i përdorur emrat në fjalë në vazhdimësi për së paku pesë vite para datës së publikimit.

AKK-ja po ashtu duhet:

- Të sigurojë që vendimi i saj i favorshëm të bëhet publik dhe çdo person fizik ose juridik që ka interes legjitim të ketë mundësi për t'u ankuar
- Të sigurojë që versioni i specifikacionit të produktit mbi të cilin bazohet vendimi i saj i favorshëm të publikohet dhe të sigurojë qasje elektronike në specifikacionin e produktit
- Të sigurojë publikim adekuat të versionit të specifikacionit të produktit mbi të cilin Komisioni do të merr vendim
- Të informojë Komisionin për kundërshtimet e pranuar nga persona fizik ose juridik, të cilët në mënyrë



ligjore i kanë futur në treg produktet në fjalë, duke i përdorur emrat në fjalë në vazhdimësi për së paku pesë vite para datës së publikimit në fjalë

- Të sigurojë që vendimi i saj i favorshëm të bëhet publik dhe çdo person fizik ose juridik që ka interes legjitim të ketë mundësi për t'u ankuar
- Të sigurojë që versioni i specifikacionit të produktit mbi të cilin bazohet vendimi i saj i favorshëm të publikohet dhe të sigurojë qasje elektronike në specifikacionin e produktit.

Duke iu referuar emërtimeve të mbrojtura të origjinës dhe treguesve gjeografik të mbrojtur, AKK-ja gjithashtu do të sigurojë publikime adekuate të versionit të specifikacionit të produktit mbi të cilin Komisioni do të merr vendimin e tij.

Hapi i radhës është procedura e shqyrtimit në nivel të BE-së. Komisioni do të shqyrtojë, me anë të veglave adekuate, çdo aplikacion, që të verifikojë përshatshmërinë dhe nëse i përmbush kushtet e skemës përkatëse. Ky shqyrtim nuk duhet të zgjat më tepër se gjashtë muaj. Komisioni, së paku çdo muaj, do të publikojë listën e emrave të aplikacioneve të dorëzuara për regjistrim, si dhe datën e dorëzimit të tyre.

Nëse Komisioni çmon se emri mund të kualifikohet për t'u regjistruar për mbrojtje, atëherë ai e publikon në OJEU të ashtuq. 'Dokument të Vetëm', cili i përmban pikat kryesore të specifikacionit (Neni 8(1) (c) i Rregullativës) dhe referencën për publikimin e specifikacionit të kompletuar sipas vendit të origjinës. Në qoftë se nuk janë dorëzuar fare kundërshtime sipas Nenit 51 të Rregullativës, emri do të futet në regjistrin e emërtimeve gjeografike të mbrojtura dhe treguesve gjeografik të mbrojtur, si dhe do të publikohet në OJEU.

Çdo Vend tjetër anëtar ose vend i tretë, si dhe të gjithë personat që kanë interes legjitim, banorë të një vendi tjetër anëtar ose vendi të tretë, mund të parashtrojnë kundërshtim ndaj regjistrimit të propozuar (Neni 51(1) i Rregullativës).

Kundërshtimet mund të bazohen vetëm në arsyet e cekura në Nenin 10(1) të Rregullativës, në *fakt*:

- a) Kushtet që referohen në Nenin 5 të Rregullativës për emërtimeve të origjinës ose treguesit gjeografik ose kushtet e referuara në Nenin 7(1) të Rregullativës për specifikacionet, të cilat nuk janë në përputhje
- b) Emri i propozuar bie ndesh me emrin e një varieteti bimësh ose racë shtazore ose me një emër të regjistruar ose një markë tregtare të njohur në përputhje me Nenin 6(2), (3) ose (4) të Rregullativës.

c) Regjistrimi i emrit të propozuar do të rrezikonte ekzistencën e një emri homonim të pjesëshëm ose në tërësi ose një markë tregtare ose ekzistencën e produkteve, të cilat kanë qenë në treg në mënyrë të ligjshme për së paku pesë vite para datës së publikimit në përputhje me Nenin 50(2)(a) të Rregullativës;

d) Emri regjistrimi i të cilit kërkohet të bëhet është emër gjenerik.

Nëse deklarata e arsyetuar e kundërshtimit pranohet, atëherë Komisioni do t'i ftojë palët e përfshira, në hapin e parë, për të arritur marrëveshje. Në qoftë se nuk arrihet marrëveshje, Komisionit do të merr vendim, në kuadër të procedurës së komisionit nëse emri do të futet në regjistrin e emrave të mbrojtur ose jo.

Pas mbarimit të procedurës, AKK-ja e publikon versionin e specifikacionit të produktit që e siguron bazën për regjistrimin e një treguesi gjeografik të mbrojtur ose një emërtimi të mbrojtur të origjinës në Gazetën Zyrtare.

Komisioni mund ta anuloj regjistrimin me iniciativë të vet ose me kërkesë të një vendi anëtar ose një personi fizik ose juridik që ka interes legjitim, në qoftë se kushtet e specifikacionit për një produkt bujqësor ose artikull ushqimor nuk përmbushen ose nëse asnjë produkt nuk është futur në treg në bazë të emërtimeve të mbrojtur të origjinës ose treguesit gjeografik të mbrojtur gjatë shtatë viteve të kaluara (Neni 54 i Rregullativës).

Shënim:

Në vitin 2019, BE-ja filloi me një bazë të dhënash publike 'eAmbrosia – Regjistri i BE-së për Treguesit Gjeografik' i cili do të ofrojë qasje të lehtë në informacione për të gjithë Treguesit Gjeografik të BE-së (GI), përfshi dhe statusin e tyre (ka aplikuar, është publikuar ose regjistruar), specifikacionin e tyre të produktit dhe një link të drejtpërdrejtë për bazën juridike kur ato fitojnë statusin zyrtar të mbrojtjes¹⁰.

¹⁰ Gjatë vitit 2019, kjo nismë do të zhvillohet në tri faza. Fillimisht, baza e të dhënave do të përbëjë vetëm verërat GI të BE-së. Deri në verën e vitit 2019, ai do të përfshijë edhe pije alkooolike GI të BE-së. Në fund, deri në fund të vitit 2019, të gjithë agri-produktet ushqimor GI të BE-së do të jenë pjesë e bazës së të dhënave eAmbrosia. E disenjuar për të zëvendësuar bazat aktuale të të dhënave për verërat (e-Bacchus), pijet alkooolike (e-Spirit-Drinks) dhe ushqimet (Door), eAmbrosia do të jetë një vegël e lehtë për të kërkuar. Ky sistem i ri do të thjeshtësojë kërkimin e informacioneve për Treguesit Gjeografik dhe do të rrit transparencën për prodhuesit, autoritetet kombëtare dhe gjithësecilin që është kureshtar për GI-të e BE-së.

3. PËRMBAJTJA e APLIKACIONIT për REGJISTRIM

Regjistrimi është si rrjedhojë e një iniciative private vullnetare e prodhuesve në fjalë: hapi i parë është të dorëzohet aplikacioni për regjistrim.

Sistemi është në bazë vullnetare dhe i hapur. Çdo prodhues që gjendet në rajon dhe i respekton kushtet e prodhimit të specifikuar në specifikacionin e produktit ka të drejtë të shfrytëzojë emrin e regjistruar për të futur në treg produktin e tij. *Prandaj, si parim, aplikacionet bëhen në emër të grupit të prodhuesve. Një grup nënkupton çdo shoqatë të fermerëve, prodhuesve dhe/ose përpunuesve që merren me të njëjtin produkt.*

Palët tjera të interesuara, për shembull konsumatorët, gjithashtu mund të marrin pjesë në atë grup. Grupet e tilla përgatisin e përgatisin aplikacionin së bashku për të regjistruar produktet e tyre. Në të vërtetë, në bazë të Rregullativës, çdo prodhues që është i etabluar në zonën e përcaktuar gjeografike mund të shfrytëzojë emrin përderisa të gjitha kushtet e specifikacioneve përmbushen. Specifikacionet duhet të jenë transparente, qartësisht të definiara dhe të jenë publike. Kjo duhet të sigurohet nëpërmjet përshkrimit të përpiktë dhe të hollësishëm të produktit në fjalë dhe metodës së prodhimit të tij.

Aplikacioni/kërkesa duhet qartë të theksojë nëse emri duhet të regjistrohet si një Tregues Gjeografik i Mbrojtur ose si një emërtim i mbrojtur i origjinës.

Aplikacioni për regjistrimin e emrit duhet të përfshijë elementet vijuese:

Aplikacioni për regjistrimin e emërtimit të origjinës ose treguesit gjeografik duhet të përfshijë, së paku:

- Emrin dhe adresën e grupit të aplikantëve
- Emrin dhe adresën e autoriteteve
- Emrin dhe adresën e organeve që e verifikojnë pajtueshmërinë me dispozitat e specifikacionit të produktit;
- Specifikacioni i produktit;
- Të sigurohen informacione për çdo element të nevojshëm dhe për të gjithë dokumentet tjera sho-

qëruese. Për shembull, dokumentet të tilla mund të përfshijnë rezultate të hulumtimeve ose punime letrare që e provojnë reputacionin e emrit ose harta që tregojnë elementet natyrore të caktuara të zonës gjeografike. Dokumente tjera plotësuese ilustrative siç janë fotografitë, menytë, receta ose faturat mund të jenë të dobishme.

➤ Dokumenti i Vetëm që i përfshi elementet në vijim:

- ❖ Pikat kryesore të specifikacionit të produktit: emrin, një përshkrim të produktit, përfshi, aty ku duhet, rregullat specifike lidhur me paketimin dhe etiketimin, si dhe një definicion konciz të zonës gjeografike;
- ❖ Një përshkrim të lidhjes ndërmjet produktit dhe mjedisit gjeografik ose origjinës gjeografike, siç e kërkon nevoja, elementet specifike të përshkrimit të produktit ose metodën e prodhimit që e justifikon atë lidhje.

Kur aplikacioni vjen nga një vend i BE-së, atëherë nevojitet deklarata e Vendit Anëtar, me të cilën aplikacioni i dorëzuar nga grupi i aplikantëve dhe se kualifikohet për një vendim të favorshëm, i plotëson kushtet e kësaj Rregullative dhe dispozitave të përcaktuara në të;

Aplikacioni për regjistrimin e TSG-së i përmban kushtet e njëjta përveç Dokumentit të Vetëm¹¹, dokumenti për specifikacionin e prodhimit plotësohet. (Siç është treguar më poshtë).

Dokumente plotësuese për aplikim në nivel të BE-së

Përveç dokumenteve të mëhershme, kur aplikacioni dërgohet nga vendet e treta, ai duhet të përfshijë prova që emri i produktit është i mbrojtur në vendin e origjinës.

Kur aplikacioni/kërkesa i dërgohet BE-së nëpërmjet Autoriteteve Kombëtare Kompetente (AKK), atëherë dosja e aplikacionit duhet të përfshijë:

- *Emrin dhe adresën e grupit të aplikantëve*
- *Dokumentin e Vetëm*
- *Një deklaratë nga vendi i tretë me të cilën konsideron që aplikacioni i depozituar nga grupi i aplikantëve dhe vendimi i favorshëm i përmbush kushtet e kësaj Rregullative, si dhe dispozitat e miratuara në bazë të tyre*
- *Referencën e publikimit të specifikacionit të produktit.*

¹¹ Linku i formularëve: https://ec.europa.eu/info/publications/quality-schemes-applications-food-and-agricultural-products_en



Nevojiten shpjegime plotësuese kur aplikacioni i dërgohet drejtpërdrejtë BE-së nga grupi i prodhuesve: emrin dhe adresën dhe kontakt detajet e autoritetit publik ose organit për certifikim të produktit (nëse janë më tepër se një, jep më shumë hollësi për të gjithë). Po ashtu, duhet të përfshihen edhe shtojcat vijuese:

Verifikimi i pajtueshmërisë me specifikacionin para se të futet produkti në treg duhet të kryhet nga: një ose më tepër autoritete publike të emërtuara nga shteti i tret; dhe/ose një ose më tepër trupa për certifikim të produkteve.

Në lidhje me trupat e kontrollit/trupat e certifikimit të produkteve, duhet të sigurohet provë të akreditimit me standardin EN ISO/IEC 17065:2012. Fushëveprimi i akreditimit duhet të mbulojë kontrollin e treguesve gjeografik. Akreditimi mund të kryhet vetëm nga një trup kombëtar i akreditimit në Union në përputhje me dispozitat e Rregullativës (EC) Nr. 765/2008; ose një trup akreditimi jashtë Unionit që është nënshkruar i një marrëveshjeje shumëpalëshe për njohje nën ombrellën e Forumit Ndërkombëtar për Akreditime.

- Për autoritetet publike, një deklaratë e qëndrimit të tyre, kapaciteteve dhe përshtatshmërisë së funksioneve të tyre nga autoritetet kombëtare adresuar Komisionit (shih më poshtë)
- Për organet e certifikimit të produkteve, certifikatën e tyre të akreditimit dhe statusin e autoritetit të akreditimit si anëtar i IAF ose në BE. (shih më poshtë)
- Listën e detyrave specifike të autoriteteve ose organeve.

SINGLE DOCUMENT

'...'

EU No: _____

PDO () PGI ()

1. **NAME(S)**
"..."
2. **MEMBER STATE OR THIRD COUNTRY**
....
3. **DESCRIPTION OF THE AGRICULTURAL PRODUCT OR FOODSTUFF**
 - 3.1. **Type of product**
....
 - 3.2. **Description of product to which the name in (1) applies**
....
 - 3.3. **Feed (for products of animal origin only) and raw materials (for processed products only)**
....
 - 3.4. **Specific steps in production that must take place in the identified geographical area**
....
 - 3.5. **Specific rules concerning slicing, grading, packaging, etc. of the product the registered name refers to**
....
 - 3.6. **Specific rules concerning labelling of the product the registered name refers to**
....
4. **CONCISE DEFINITION OF THE GEOGRAPHICAL AREA**
....
5. **LINK WITH THE GEOGRAPHICAL AREA**
....

Reference to publication of the specification
(See second subparagraph of Article 6(1) of this Regulation)

PRODUCT SPECIFICATION OF A TRADITIONAL SPECIALITY GUARANTEED

[Insert name, as in 1 below] "..."

EC No: [for EU use only]

Member State or Third Country "..."

1. **NAME(S) TO BE REGISTERED**
"..."
2. **TYPE OF PRODUCT [AS IN ANNEX XI]**
....
3. **GROUND(S) FOR REGISTRATION**
 - 3.1. **Whether the product:**
 - results from a mode of production, processing or composition corresponding to traditional practice for that product or foodstuff
 - is produced from raw materials or ingredients that are those traditionally used.
[Provide explanation]
 - 3.2. **Whether the name:**
 - has been traditionally used to refer to the specific product
 - identifies the traditional character or specific character of the product
[Provide explanation]
4. **DESCRIPTION**
 - 4.1. **Description of the product to which the name under point 1 applies, including its main physical, chemical, microbiological or organoleptic characteristics showing the product's specific character (Article 7(2) of this Regulation)**
....
 - 4.2. **Description of the production method of the product to which the name under point 1 applies that the producer must follow including, where appropriate, the nature and characteristics of the raw material or ingredients used, and the method by which the product is prepared (Article 7(2) of this Regulation)**
....
 - 4.3. **Description of the key element establishing the product's traditional character (Article 7(2) of this Regulation)**
....

Burimi: Elaborimi i vetë autorit duke u bazuar në udhëzimet zyrtare të BE-së

3.1 Dosja e aplikacionit: disa shpjegime

3.1.1 Emri dhe adresa e grupit të aplikantëve

✓ **Specifiko emrin dhe adresën e grupit të aplikantëve**

Grupi i aplikantëve duhet të ketë status juridik (shoqatë, kooperativë, etj.) me një EMËR (i cili mund të jetë emër i një personi fizik ose juridik) dhe një Adresë të Vetme në Vend (telefoni, fakti, dhe e-maili janë të parapëlqyeshëm).

Grupet që punojnë me produktet për të regjistruar emrin e tyre mund të dorëzojnë aplikacione për regjistrim të emrit vetëm sipas skemave së cilësisë. Në rastin e emrit të emërtimeve të mbrojtura të origjinës ose 'Treguesve gjeografik të mbrojtur' e emërton zonën tej-kufitare gjeografike ose në rastin e emrit të 'specialiteteve tradicionale të garantuara', disa grupe nga vende të ndryshme anëtare të BE-së ose vende të treta mund të depozitojnë një aplikacion të përbashkët për regjistrim.

Vetëm një shoqatë prodhuesish ose përpunuesish të produkteve mund të depozitojë aplikacionin për regjistrim. Në raste të jashtëzakonshme, një person fizik ose juridik/individ po ashtu mund të depozitojë një aplikacion, mirëpo në thelb, ai duhet të shpjegohet se ai është i vetmi prodhues në atë zonë; dhe se karakteristikat e zonës ose produktit/artikullit ushqimor të prodhuar në atë zonë dallojnë nga produktet e prodhuara jashtë zonës.

Hollësitë vijuese të Grupit të Aplikantëve duhet të përfshihen në një faqe të veçantë:

- Emri, adresa (telefoni, fakti, e-maili, nëse kanë),
- Statusi juridik (sipas ligjeve kombëtare),
- Madhësia (sa anëtarë janë në grup), dhe
- Përbërja (roli ose profesioni i anëtarëve: fermerëve, prodhuesve, distributorëve, punonjësit e dorës së fundit, paketuesve, etj.).

STATUSI JURIDIK i prodhuesve – nënkupton që të gjithë prodhuesit e produktit të mundshëm nga grupi duhet të jenë të regjistruar si prodhues ushqimor ose të miratohen nga autoritetet kompetente në shtetin/rajonin përkatës (**Numër Juridik Regjistrimi**). Kjo nënkupton që të gjithë prodhuesit ushqimor që kanë ndër mend të mbrojnë produktet e tyre duhet të implementojnë standardet GHP, GMP dhe HACCP

fleksibël, të fitojnë statusin juridik – të regjistruar nga autoriteti kompetent dhe pastaj të depozitojnë aplikacionin/kërkesën.

3.1.2 Emri dhe adresa e autoriteteve

✓ Specifiko emrin dhe adresën dhe kontakt detajet e autoritetit publik ose organit për certifikim të produkteve (nëse janë më tepër se një, jepni hollësi për të gjithë).

✓ Në një shtojcë – jepni më tepër informacione për autoritetet publike si p.sh.: një deklaratë të qëndrimit të tyre, kapaciteteve dhe përshtatshmërisë së funksioneve të tyre nga autoritetet kombëtare adresuar Komisionit;

ARSYETIM

Në Rregullativë është e qartë që mbrojtja që ofrohet duhet të jetë e qasshme në mënyrë të barabartë për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografik të vendeve të treta që i përmbushin kriteret përkatëse dhe që janë të mbrojtur në vendin e tyre të origjinës.

Në çdo shtet, autoritetet kompetente kombëtare duhet të marrin masa përkatëse për të mbrojtur emrat në kuadër të territorit të tyre, për të gjitha skemat e cilësisë të përcaktuara në Reg. 1151/2012. Gjithashtu, ato duhet të parandalojnë dhe ndalojnë çdo prodhim ose tregtim të produkteve që e përdorin atë emër.

Prandaj, çdo shtet duhet të emërtojë autoritetet përgjegjëse për:

- Ekzaminimin nëse aplikacionet i përmbushin të gjitha kushtet e rregullativës;
- Procedurat kombëtare të kundërshtimit/ankimit
- Publikimin e vendimit të favorshëm (së bashku me specifikacionin e produktit) që të mundësohen ankesa; dhe,
- Ridërgimin e aplikacionit Komisionit ose refuzimin e aplikacionit.

Autoritetet kombëtare të shtetit në fjalë, në pajtim me dispozitat minimale të përbashkëta, përfshi dhe procedurat kombëtare, duhet të ekzaminojnë aplikacionet e grupit të prodhuesve. Komisioni pastaj do të shqyrtojë hollësisht aplikacionet për të siguruar që nuk ka gabime dhe se Legjislacioni i BE-së dhe interesat e aktorëve jashtë BE-së janë marrë parasysh.

Autoritetet kompetente në vendet përkatëse duhet të përmbushin një numër të caktuar të kriterëve operacionale që të sigurojnë se janë të paanshëm dhe efektiv. AKK-ja do të ofrojë garanci adekuate për objektivizmin dhe paanësinë, si dhe janë të nevojshme burime dhe personel i kualifikuar për të kryer funksionet e



tyre. Gjithashtu, duhet të parashikohen edhe dispozita për të deleguar disa kompetenca për kryerjen e detyrave specifike të kontrollit, organeve të kontrollit. Autoriteti kompetent duhet po ashtu të shqyrtojë hollësisht aplikacionin me ndihmën e mjeteve të përshtatshme që të verifikojë se ai është i përshtatshëm dhe i plotësion kushtet e skemës përkatëse.

Vendet Anëtare të vendit përkatës duhet të ndërmarin masa të duhura administrative dhe juridike për të parandaluar ose ndaluar përdorimin e paligjshëm të emërtimeve të mbrojtura të origjinës dhe tregusve gjeografik të mbrojtur, të cilat prodhohen ose shiten në treg në atë vend/shtet.

Shtetet duhet të caktojnë autoritetet që janë përgjegjëse për ndërmarrjen e të gjitha hapave në pajtim me procedurat e përcaktuara në RrEG. 1151/2012.

Këto autoritetet duhet të sigurojnë garanci adekuate të objektivizmit dhe paanësisë, si dhe duhet të kenë personel të kualifikuar dhe burime të nevojshme për të kryer funksionet e tyre.

3.1.3 Emri dhe adresa e organeve që e verifikojnë pajtueshmërinë me dispozitatat e specifikacionit të produktit

✓ Thekso emrin dhe adresën dhe kontakt detajet e organit për certifikim të produkteve (nëse janë më tepër se një, jepni hollësi për të gjitha).

✓ Në një shtojcë – jepni më tepër informacione si p.sh.: certifikatën e tyre të akreditimit dhe statusin e autoritetit të akreditimit si anëtar i IAF ose BE.

✓ Gjithashtu mund të listohen edhe detyrat specifike të autoriteteve ose organeve.

Shënim kryesor

Pajtueshmëria e specifikacionit patjetër duhet t'i nënshtrohet verifikimit. Kjo mund të bëhet ose nga autoritetet publike ose nga një organ i certifikimit të produkteve. Në qoftë se autoritetet publike kryejnë kontrole të këtilla të verifikimit, atëherë ato duhet të ofrojnë garanci të paanësisë dhe objektivitetit, si dhe të kenë personel të kualifikuar dhe burime të nevojshme për të kryer ato kontrole.

Në qoftë se kontrollet për verifikim kryeh nga një organ për certifikimin e produkteve, atëherë ai duhet të jetë i akredituar në pajtueshmëri me ISO /IEC Guide 65 (Kushtet e përgjithshme për organet të kryejnë sisteme për certifikim të produkteve). Autoriteti i akreditimit duhet të njihet nga organizata IAF (Forumi Ndërkombëtar i Akreditimeve, ang. International Accreditation Forum) ose të jetë autoritet akreditimi i një Vendi Anëtar i BE-së.

Arsyetimi

Çdo vend/shtet duhet të ketë struktura të inspektimit që të sigurohet se respektohen kushtet e përcaktuara në specifikacione. Shtetet janë të obliguara të krijojnë organe të nevojshme të kontrollit për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat e BE-së. Zbatimi i skemës kryhet nga autoritetet e caktuara nga shteti/vendi, të cilat veprojnë brenda rregullave të përcaktuara në nivel të BE-së.

Vendet Anëtare ose vendet e treta vetëm duhet të sigurojnë që strukturat e inspektimit janë funksionale që të garantohet përmbushja e kushteve të përcaktuara në specifikacione.

Vlera e shtuar e treguesve gjeografik dhe specialiteteve tradicionale bazohet në besimin e konsumatorëve. Ajo është e besueshme vetëm nëse shoqërohet me një verifikim dhe kontroll efektiv. Ato skema të cilësisë duhet t'i nënshtrohen një sistemi të monitorimit të kontroleve zyrtare, në pajtim me parimet e përcaktuara në Rregullativën (KE) Nr. 882/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, më datë 29.04.2004 mbi kontrollet zyrtare për të siguruar verifikimin e pajtueshmërisë me Ligjin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë (foragjere), shëndetin e shtazëve dhe rregullave për mirëqenien e shtazëve, si dhe duhet të përfshijë një sistem të kontrollit në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimin dhe distribuimit.

Që të ndihmojë shtetet për të zbatuar më mirë dispozitat e Rregullativës (KE) Nr. 882/2004 për kontrollet e GI-ve dhe TSG-ve, duhet të përmenden referenca për nenet më të rëndësishme në legjislacionin kombëtar lidhur me skemat e cilësisë.

Duhet të përfshihen informacione mbi aktivitetet e kontroleve për treguesit gjeografik dhe specialitetet tradicionale në **planet shumëvjeçare të kontrollit kombëtar** dhe raportin vjetor të përpiluar nga Vendet Anëtare ose vendet e treta në pajtueshmëri me Rregullativën (EU) Nr. **625/2017**.

3.1.3.1 Emërtimi i një organi kompetent për kontrolle zyrtare

Në pajtim me Rregullativën (EU) Nr. **625/2017**, shtetet do të emërojnë autoritete kompetente përgjegjëse për kontrollet zyrtare për të verifikuar pajtueshmërinë me kërkesat ligjore lidhur me skemat e cilësisë të themeluara me Rregullativën 1151/2012. Procedurat dhe kërkesat e Rregullativës (EU) Nr. **625/2017** do të vlejnjë *mutatis mutandis* për kontrollet zyrtare të realizuara për të verifikuar pajtueshmërinë me kërkesat ligjore lidhur me skemat e cilësisë për të gjithë produktet që i mbulon Shtojca I e Rregullativës 1151/2012.

Kontrollet zyrtare do të përfshijnë:

- Verifikimin që një produkt është në pajtueshmëri me specifikacionin korrespondues të produktit; dhe
- Monitorimin e përdorimit të emrave të regjistruar për të përshkruar produktin e futur në treg, në pajtueshmëri me emrat e regjistruara si PDO, GI ose TSG.

3.1.3.2 Verifikimi i pajtueshmërisë me specifikacionin e produktit

Në lidhje me emërtimet e origjinës, treguesve gjeografik dhe specialiteteve tradicionale të garantuara që i caktojnë produktet që origjinojnë nga një vend i tretë, verifikimi i pajtueshmërisë me specifikacionet para se të futet produkti në treg, do të kryhet nga:

- Një ose më tepër autoritete publike të caktuara nga vendi i tretë; dhe/ose
- Një ose më tepër organe për certifikim të produkteve

Shtetet duhet t'i publikojnë emrat dhe adresat e autoriteteve dhe organeve, si dhe të përditësojnë ato informacione periodikisht. Shtetet duhet të informojnë Komisionin për emrat dhe adresat e autoriteteve kompetente, ndërsa Komisioni do të publikojë emrat dhe adresat e organeve dhe autoriteteve kombëtare dhe do të përditësojë ato informacione periodikisht.

Është e rëndësishme të sigurohet mbikëqyrja e përdorimit të emrit në tregun në fjalë. Prandaj, çdo shtet do të kryej kontrolle, duke u bazuar në një analizë të risku, për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat ligjore të Rregullativës dhe, në rast të shkeljeve, shtetet duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme.

Autoritetet kompetente mund t'i delegojnë një ose më tepër organeve të kontrollit detyra specifike lidhur me kontrollet zyrtare të skemave të cilësisë. Organet e tilla të kontrollit duhet të akreditohen në pajtueshmëri me standardin evropian ISO/IEC 17065 (vlerësimi i pajtueshmërisë – Kushtet e përgjithshme për trupat që funksionojnë me sisteme për certifikim të produkteve, përpunimeve dhe shërbimeve.

Autoritetet kompetente duhet të jenë në gjendje t'iu delegojnë disa nga detyrat e tyre trupave të tjera.

Duhet të krijohen kushte të përshtatshme për të siguruar paanësinë, cilësinë, konzistencën e kontrolleve zyrtare dhe të aktiviteteve tjera zyrtare. Në veçanti, trupi i deleguar duhet të akreditohet në përputhshmëri me Organizatën Ndërkombëtare të Akreditimit – standardi ISO për kryerjen e inspektimeve.

Trupi i deleguar duhet të funksionojë dhe të jetë i akredituar në përputhje me standardet përkatëse të detyrave në fjalë, përfshi edhe standardin EN ISO/IEC 17020 'Kushtet për funksionimin e llojeve të ndryshme të trupave që kryejnë inspektime'.

Planifikimi dhe raportimi i aktiviteteve të kontrollit – çdo shtet duhet të sigurojë që autoritetet e kontrolleve të jenë të përfshira në një seksion të veçantë brenda planeve të kontrollit shumëvjeçar kombëtar. Raportet vjetore lidhur me kontrollin e detyrimeve të përcaktuara nga Rregullativa do të përfshijnë një seksion të veçantë, i cili do të përbëjë informacionet e përcaktuara në Nenin 113 të Rregullativës (EU) Nr. 625/2017¹².

¹² Rregullativa (EU) 2017/625 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 15 mars 2017 mbi kontrollet zyrtare dhe autoritetet tjera zyrtare të kryera me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjit për ushqim dhe foragjere, rregullave mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve.



4. SPECIFIKACIONI I PRODUKTIT

Që të përfitohet nga mbrojtja që caktohet për një Tregues Gjeografik (dhe për t'u kualifikuar për regjistrim), rregulativat e BE-së përcaktojnë se një produkt bujqësor, artikuj ushqimor, vera ose pijet alkoolike duhet t'i përmbahen një "specifikacioni të prodhimit".

Specifikacioni i produktit paraqet dokumentin kryesor, i cili përmban informacione rreth produktit, tiparet e tij konkrete, zonën e prodhimit, si dhe e shpjegon lidhjen ndërmjet mjedisit gjeografik dhe produktit në fjalë. Specifikacioni duhet qartësisht të theksojë nëse emri do të regjistrohet si një tregues gjeografik i mbrojtur ose si një emërtim të mbrojtur të origjinës.

Prandaj, specifikacioni paraqet *dokumentin e identifikimit për produktin, i përgatitur dhe prezantuar (gjatë procesit të aplikimit) i cili i përcakton rregullat dhe kushtet e hollësishme për prodhimin e një produkti që duhet emërtuar si një produkt me status PDO ose PGI.*

Në bazë të Rregullativës (KE) Nr. 1151/2012 (Neni 7) të Parlamentit dhe Këshillit më datë 21.11.2012 mbi skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe artikujt ushqimor për mbrojtjen e Treguesve Gjeografik dhe Emërtimeve të Origjinës për produkte bujqësore dhe artikuj ushqimor, që e zëvendëson Rregullativën e Këshillit (KE) Nr. 510/2006, një specifikacion produkti duhet të përfshijë së paku elementet vijuese:

1. Emërtimin e produktit (emrin e produktit)
2. Përshkrimin e produktit (lëndën e parë, karakteristikat kryesore)
3. Definimin e zonës gjeografike
4. Prova për origjinën e produktit brenda zonës gjeografike
5. Përshkrimin e metodave të prodhimit
6. Prova për lidhjen me zonën gjeografike ose origjinën gjeografike
7. Përmendja e një organi për kontroll të cilësisë
8. Rregullat specifike lidhur me etiketimin që kanë të bëjnë me shkurtime PDO ose PGI
9. Rregulativat dhe kushtet në pajtueshmëri me dispozitat kombëtare dhe të BE-së

Çdo shtet duhet të përcaktojë kriteret themelore për të formuar një kod sjelljeje, në pajtim me idenë e vetë të produkteve GI dhe nevojat e prodhuesve vendor. Është e qartë se ato elemente që e justifikojnë lidhjen ndërmjet tipareve, karakteristikave ose reputacionit të produktit dhe mjedisit gjeografik janë kryesore për të identifikuar Treguesin Gjeografik.

4.1 Emërtimi i produktit (emri i produktit)

Ai përfshin emrin që duhet të mbrohet si një tregues gjeografik (GI), ashut siç përdoret, qoftë në tregti ose në gjuhën e zakonshme, dhe vetëm në ato gjuhë të cilat janë historikisht të përdorura për të përshkruar një produkt specifik në zonën e përcaktuar gjeografike.

Një emër mund të mos regjistrohet si emërtim i origjinës ose tregues gjeografik nëse bie ndesh me një emër të një varieteti bimësh ose një racë shtazore dhe i cili mund të krijoj hutitë tek konsumatori për origjinën e vërtetë të produktit. Një emër që propozohet për regjistrim, i cili është pjesërisht ose tërësisht homonim me emrin që tashmë është futur në regjistër sipas Nenit 11 të Rregullativës së BE-së, mund të mos regjistrohet si i tillë përveç nëse nuk ka dallim të mjaftueshëm ndërmjet kushteve të përdorimit lokal dhe tradicional dhe prezantimit të homonimit të regjistruar më pas, ndërsa emri që tashmë është futur në regjistër, duke e marrë parasysh nevojën për të siguruar trajtim të barabartë të prodhuesve në fjalë dhe shmangien e hutisë së konsumatorëve.

Një emër homonim i cili krijojnë hutitë tek konsumatori për të besuar se produktet vijnë nga një territor tjetër nuk do të regjistrohet edhe nëse emri është i saktë për sa i përket territorit aktual, rajonit ose vendit të origjinës së produktit në fjalë.

Një emër i propozuar për regjistrim për të fituar statusin e emërimit të origjinës ose treguesit gjeografik nuk do të regjistrohet nëse, në përputhje me reputacionin e markës tregtare dhe kohëzgjatjes që është përdorur, regjistrimi i emrit të propozuar për emërtim të origjinës ose tregues gjeografik do të ishte përgjegjës të krijoj hutitë në mesin e konsumatorëve sikur të jetë identiteti i vërtetë i produktit.

Fjalët që kanë kuptime të caktuara përshkrimore, siç janë 'origjinal', 'tradicional', 'shtëpi-fermë', 'natyral', etj., zakonisht duhet të shmangen, përveç nëse kjo nuk është pjesë përbërëse e emrit që përdoret për të përshkruar produktin.

Kutia 1. Shembull i emërimit të produktit – Djathi Italian PDO Asiago

SPECIFIKACIONI I PRODUKTIT

PDO "ASIAGO"

(Dekret ministror 03/08/2006 Gazeta Zyrtare nr. 190, 17/08/06)

Neni 1: Emri

Emërtimi i mbrojtur i origjinës "Asiago" është i rezervuar për djathin gjysmë të gatuar, i prodhuar prej qumështit të lopës, i fituar në pajtim me këtë specifikacion. Prodhimi ndahet në dy lloje të djathit, Asiago të shtypur dhe Asiago të kultivuar, karakteristikat e të cilit përshkruhen më poshtë.

Burimi: <https://www.asiagochese.it/en/consortium/production-rules>

Kutia 2. Shembull i treguesit gjeografik të produktit – Vaj Ulliri Extra Virgin 'Toscano', PGI Italiane

SPECIFIKACIONI I PRODHIMIT "TOSCANO"

VAJ ULLIR EXTRA VIRGIN,

TREGUESI GJEOGRAFIK I MBROJTUR

1. Emërtimi

Treguesi gjeografik i mbrojtur 'Toscano', që shoqërohet me një ndër referencat plotësuese gjeografike: "Seggiano", "Colline Lucchesi", "Colline della Lunigiana", "Colline di Arezzo", "Colline Senesi", "Colline di Firenze", "Montalbano", "Monti Pisani" është i rezervuar për vajin e ullirit i cili i plotëson kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në specifikacionin e prodhimit brenda këtij dokumenti.

Burimi: <https://www.oliotoscanoigp.it/cms/doc/DisciplinareOlioToscanoIGPEn.pdf>

Sipas shembullit të dytë (Kutia 2), PGI-ja Vaj Ulliri Extra Virgin mund të prodhohet në rajonin e Toskana dhe rrjedhimisht mund të shoqërohet edhe me referenca plotësuese gjeografike (brenda rajonit të njëjtë administrativ të ashtuq. "Tuscany") (shih pikët e mëposhtme).

Kutia 3. Shembull i emërimit të produktit – PDO Parma Ham

EMRI I PRODUKTIT: PROSCIUTTO DI PARMA (PARMA HAM)

Që në vitin 1970, emërtimi i origjinës "Prosciutto di Parma" është mbrojtur ligjërisht në nivel kombëtar në pajtim me Ligjin nr. 506, më datë 14 korrik 1970 dhe më vonë e fitoi statusin PDO në bazë të Rregullativës së KE-së Nr. 1107, më datë 12 qershor 1996, në bazë të Rregullativës së EEC nr. 2081/92

Burimi: https://www.prosciuttodiparma.com/pdf/en_UK/Parma_Ham_Specifications_Disciplinare_Consolidato_Nov_13.pdf

4.2 Përshkrimi i produktit (lënda e parë dhe karakteristikat kryesore)

Përshkrimi, kryesisht, i përcakton mënyrat sipas së cilave një produkt është specifik, si dhe jep hollësi për atë sesi do të dallohet nga produktet tjera të kategorisë së njëjtë. Specifikacioni i përpunimit, paketimit dhe prezantimi po ashtu mund të jetë i rëndësishëm sepse metodat e prerjes, copëtimit, grirjes ose paketimit mund të jenë thelbësor për mirëmbajtjen e karakteristikave dhe vlesë së produktit.

Një përshkrim të produktit, përfshi lëndën e parë, nëse është e nevojshme, si dhe karakteristikat kryesore fizike, kimike, mikrobiologjike dhe organoleptike të produktit, por gjithashtu mund të përfshijë dhe madhësitë ose peshën minimale. Ofron hollësi të hapave të prodhimit që ndodhin brenda një zonë gjeografike specifike për PDO dhe çfarë paraqet faktor të jashtëm për PGI.

Theksimi i ndikimit të mjedisit gjeografik dhe/ose ekspertiza (*savoir-faire*) e prodhuesve vendor në produktin përfundimtar.

- Atributet fizike (formën, ngjyrën, peshën, etj.)
- Tiparet kimike (përmbajtja minimale e yndyrave, përmbajtja maksimale e ujit, etj.)
- Informacione mikrobiologjike (p.sh. prania e ndonjë baktere)
- Hollësi biologjike (raca, varieteti, etj.)
- Karakteristikat organoleptike (shija, aroma, ngjyra, era, etj.)



Kutia 4. Shembull i përshkrimit të produktit – Djathi PDO Asiago

SPECIFIKACIONI I PRODUKTIT - PDO "ASIAGO"

(Dekret ministror 03/08/2006 Gazeta Zyrtare nr. 190, 17/08/06)

Neni 3: Ushim për kafshët

Bagëtitë qumështi i të cilave është për qëllim të përpunimit në djath PDO "Asiago" nuk duhet të ushqehen me foragjere siç është theksuar më poshtë:

Foragjere:

- Prodhimet bujqësore të kanollës, kolzë, mustardë, bar të thatë grek; gjethe të pemëve frutore, gjethe të mangelit dhe manikotës, bar nga silot, bizele dhe produktet anësore; Frutat dhe produktet anësore të tyre nga përpunimi industrial, të freskëta dhe të mbajtura në lagështi; perimet dhe produktet përkatëse, të freskëta dhe të mbajtura në lagështi; Produktet anësore të industrisë së fermentimit, të freskëta dhe të mbajtura në lagështi (kokrra të birës, distileri, etj.);

(. etj.)

Ushqimi për kafshët:

- mish, peshk, ushqime shpendësh; ushqim kolze, fara citrusi, fara rrushi; perime dhe fruta të thara; - përpunimi industrial i perimeve të thara dhe produkteve anësore të frutave (fasule dhe lëvore bizelesh, artiçok, gështenja, bishtaja, lëvore, fara, tufa); produkte anësore të sheqerit: koncentrat proteinash nga melasa, pupla të thara dhe të tjera; produkte të thara në fermentim industrial; fermentimi i mbetjeve, etj.

Në qoftë se qumështi është i destinuar për prodhimin e djathit PDO Asiago, i cili e mban termin "produkt malor" po ashtu është e ndaluar të ushqehet me çfarëdo lloj silazhi.

Burimi: https://www.asiagocheese.it/uploads/files_pagi-na_190920171437_Disciplinare-di-produzione_EN.pdf

Kutia 5. Shembull i përshkrimit të produktit – Vaj Ulliri PGI 'Tuscan'

SPECIFIKACIONET E PRODHIMIT TË VAJIT TË ULLIRIT "TOSCANO" EXTRA VIRGIN TREGUESI GJEOGRAFI I MBROJTUR

2. Varietetet e ullirit:

1) Treguesi Gjeografik i Mbrojtur "Toscano", pa asnjë referencë tjetër gjeografike, duhet të fitohet nga varietetet vijuese të ullinjve, të vetme ose në kombinim, në kuadër të ullishteve vijuese: Americano, Arancino, Ciliegino, Frantoio, Grappolo, Gremignolo, Grossolana, Larcianese, Lazzero, Leccino, Lecchio del Corno, Leccione, Madonna dell'Impruneta, Marzio, Maurino, Melaiolo, Mignolo, Moraiolo, Morchiaio, Olivastra Seggianese, Pendolino, Pesciatino, Piangente, Punteruolo, Razaio, Rossellino, Rossello, San Francesco, Santa Caterina, Scarlinese, Tondello dhe sinonimet e tyre. Gjithashtu, mund të ketë edhe varietete tjera me maksimum 5%.

2) Referencë tjetër gjeografike "Seggiano" është e rezervuar për Vajin e Ullirit "Toscano" Extra Virgin që fitohet nga ullinjtë me prejardhje nga ullishtet e që përbëhen nga varieteti Olivastra Seggianese. Gjithashtu, mund të pranohen edhe varietete tjera si polinator të pranishëm në ullishte për maksimum 5%.

3) Referencë tjetër gjeografike "Colline Lucchesi" është e rezervuar për Vajin e Ullirit "Toscano" Extra Virgin që fitohet nga ullinjtë e varieteteve vijuese: Frantoio ose Frantioiana deri 90%, Leccino deri 20%. Gjithashtu, mund të pranohen edhe varietete të tjera të ullinjve në ullishte për maksimum 15%.

4) Referencë tjetër gjeografike "Colline della Lunigiana" është e rezervuar për Vajin e Ullirit "Toscano" Extra Virgin që fitohet nga ullinjtë e varieteteve vijuese: Frantoio ose Frantioiana deri 90%, Leccino deri 20%. Gjithashtu, mund të pranohen edhe varietete të tjera të ullinjve në ullishte për maksimum 15%.

5) (..etj.)

Burimi: <https://www.oliotoscanoigp.it/cms/doc/DisciplinareOlioToscanoLGPEn.pdf>

4.3 Definimi i zonës së përcaktuar gjeografike

Zona gjeografike paraqet elementin kryesor për GI-të. Procesi i definimit të kufijve fizik të zonës së prodhimit për një produkt lokal është një hap i rëndësishëm dhe thelbësor. Zona gjeografike korrespondon me territorin në të cilin produkti GI po përpunohet (ose mund të përpunohet) sipas fazave që e definojnë produktin GI (lënda e parë, përpunimi, etj.).

Specifikacioni i produktit duhet të përfshijë saktësisht kufijtë e zonës gjeografike, duke shfrytëzuar dokumentacion shoqëruës, përfshi dhe harta. Përcaktimi i kufijve duhet të bazohet në lidhjen ndërmjet produktit dhe origjinës së tij gjeografike. Çdo përcaktim kufiri kërkon qasje kolektive nga palët e interesit të përfshirë në hapat e regjistrimit. Mirëpo, nuk ka qasje standarde të BE-së drejt përcaktimit të kufijve të zonës për GI. Çdo shtet e ka metodën dhe procedurat e veta për të përcaktuar kufijtë. Mirëpo, si një rregull i përgjithshëm, zona gjeografike përcaktohet në mënyrë të hollësishme, të përpiktë duke u bazuar në prova lidhur me kushtet historike, gjeologjike, agronomike dhe klimatike.

Kufijtë gjeografik po përcaktohen nga faktorët natyror dhe njerëzor, mirëpo jo domosdoshmërisht sipas kufijve administrativ. Nganjëherë, specialistë sikur historianët, gjeologët, ekonomistët, etj., ftohen të ndihmojnë për të përcaktuar kufirin e zonës. Procesi i përcaktimit të kufijve duhet të mer parasysh kriteret të llojllojshme:

- Kriteret fizik, si p.sh., dheun, klimën, topografinë, furnizimin me ujë, etj.
- Praktikë lokale siç janë kushtet e kultivimit, varietetet, vjeljen, praktikat e përpunimit, etj.
- Historinë lokale të prodhimit dhe reputacionin e GI-ve: të dhëna historike dhe burime të dokumentuara (literaturë, ligje, receta, por po ashtu edhe burime siç janë historitë dhe narrativët) përmendja e produktit dhe origjinës gjeografike në të kaluarën po ashtu mund të merret parasysh dhe të prezantohet me qëllim për të demonstruar prodhimin historik. Atje ku aplikacioni i GI-ve bazohet në reputacion, shpjegoni se çfarë nënkupton ai reputacion dhe si ndërlihet reputacioni me një produkt të zonës gjeografike në fjalë.

Kur zona e GI-ve përfshin rajonin e dy Vendeve Anëtare, sistemi GI i BE-së siguron kushte për regjistrimin e GI-së ndërkufitare¹³.

Kutia 6. Përshkrimi i zonës së prodhimit: Shembulli i djathit PDO Asiago

SPECIFIKACIONI I PRODUKTIT

PDO "ASIAGO"

(Dekret ministror 03/08/2006 Gazeta Zyrtare nr. 190, 17/08/06)

Neni 2 Zona e prodhimit

Djathi PDO "Asiago" prodhohet nga qumështi i bagëtitive që gjendet në një zonë të caktuar si dhe në bylmetet që ndodhen në zonën e mbrojtur si në vijim: Provincën Vicenza: tërë territorin; Provincën Trento: tërë territorin; Provincën Padova: bashkitë Carmignano di Brenta, S. Pietro in Gù, Grantorto, Gazzo, Piazzola sul Brenta, Villafranca Padovana, Campodoro, Mestrino, Veggiano, Cervarese S. Croce dhe Rovolon; Provincën Treviso: tërë territorin, të përcaktuar me kufij: duke e marr si pikëreferimi qytetin Rossano Veneto, afër Vicenza, kufiri vazhdon në rrugën Rossano - Castel Franco Veneto deri në kryqëzimin e tij me rrugën kombëtare nr. 53 "Postumia". Përgjatë kësaj rruge, arrijmë deri në Unazën në jug të Trevisos, deri në kryqëzimin e tij me autostradën Alemagna. Kufiri vazhdon në veri përgjatë rrugës së autostradës së sipërpërmendur deri në lumin Piave.

Pastaj, kthen në të bregun e djathtë të lumit deri në kufirin me Treviso dhe Belluno. Nga ky vend, kufiri identifikohet me kufirin e provincës Treviso deri në pikën kur takohet me kufirin e provincës Vicenza.

Zonat e prodhimit të sipërpërmendur, të cilat gjenden në lartësi jo më lartë se 600 metre, janë identifikuar si teritore malore.

Burimi: https://www.asiagocheese.it/uploads/files_pagina_190920171437_Disciplinare-di-produzione_EN.pdf

¹³ Një GI ndërkufitare paraqet një GI që vjen nga një zonë që mbulon territorin e dy shteteve. Ekzistojnë dispozita konkrete lidhur me mbrojtjen e GI-ve ndërkufitare për produktet bujqësore dhe artikujt ushqimor, si dhe për verërat. Shembuj të GI-ve të regjistruar si GI ndërkufitare janë: PGI Rosée des Pyrénées-Catalanes-Francë dhe Spanjë (përmishin); Sloveni-Kroaci (PGI) për Vajin e Ullirit Extra Virginnë-mrin Istria Olive Oil, Maasvallei Limburg (verë), është emërtim i mbrojtur i origjinës Belgjikë dhe Holandë (PDO), Istarski pršut / Istarski pršut »(proshutë) është PDO e Kroacisë dhe Sllovenisë. Miód z Sejneńszczyny / Łódziejszczyzny »/« Seinų / Lazdijų kraštomėdus »(mjaltë) është PDO e Polonisë dhe Lituanisë. Genièvre / Jenever / Genever »(pijealkoolike) është njëjës regues gjeografik Belgjikë, Holandë, Francë dhe Gjermanisë.



Kutia 6 e paraqet Nenin 2 të Specifikacionit të Prodhimit për djathin PDO Asiago duke iu referuar zonës së prodhimit. I referohet në hollësi kufijve administrativ (provincave dhe bashkive), kufijve fizik (p.sh., lumejve, rrugëve).

Sipas specifikacionit të produktit të Vajit të Ullirit Extra Virgin PDI 'Toscano', produkti me status PGI mund të prodhohet me ullinj brenda kufijve të rajonit Tuscany. Mirëpo, specifikacioni i produktit e mundësoi përdorimin e një reference plotësuese gjeografike nën emërtimin "Toscano PGI" (brenda rajonit të njëjtë "Tuscany") siç është "Toscano" e Colline di Firenze. Në këtë rast, çdo kufij plotësuese përshkruhen në rregullat e prodhimit.

4.4 Provat që produkti e ka origjinën në zonën e përcaktuar gjeografike

Qëllimi i kësaj pike është të theksojë përpjekjet kryesore që i siguron ndërveprimi me zonën gjeografike. Në këtë pjesë janë përshkruar në përgjithësi faktorët natyror, ndërsa vëmendje e posaçme duhet kushtuar karakteristikave të tokës brenda zonës së përcaktuar gjeografike në kombinim me kushtet klimatike, të cilat kanë efekte direkte edhe në përbërjen e lëndës së parë edhe në procesin e përpunimit (mplakja).

Kushti kryesor këtu është që aplikantët të tregojnë gjurmim të plotë të produkteve të tyre. Duhet të identifikohet një rrugë e qartë ndërmjet zonës së prodhimit dhe produktit fundor në treg. Specifikacioni duhet të demonstrojë se çfarë masash janë marr për të siguruar gjurmueshmërinë (për shembull, duke mbajtur një regjistër), që produkti dhe lënda e parë e tij, aty ku është e përshtatshme, e kanë origjinën nga zona në fjalë¹⁴.

Shmangni deklaratat e përgjithshme të pabazuara. Deklaratat duhet të jenë të përpikta: p.sh., jepni mesataren e reshjeve të shiut në mm (me kusht që kjo të jetë e rëndësishme për produktin në fjalë); shpjegoni cilat aspekte të klimës më shumë ndikojnë në produktin, etj.

¹⁴ https://ec.europa.eu/agriculture/publi/fact/quality/2007_en.pdf

Kutia 7. Shembull i provave që produkti e ka origjinën nga zona e përcaktuar gjeografike për djathin PDO Asiago

SPECIFIKACIONI I PRODUKTIT PDO "ASIAGO"

(Dekret ministror 03/08/2006 Gazeta Zyrtare nr. 190, 17/08/06)

Neni 4: Origjina e produktit

Çdo fazë e procesit të prodhimit monitorohet, për çdo hyrje dhe dalje (input and output). Në këtë mënyrë, sigurohet gjurmueshmëria e produktit duke e regjistruar në lista konkrete, menaxhohet nga strukturat e kontrollit, nga prodhuesit e qumështit, vjelësit, përpunuesit, paketuesit dhe pjekuria e djathit pa koren, si dhe deklarimi me kohë i sasive të prodhuara para strukturave të kontrollit. Procesi i verifikimit dhe mospajtueshmëria e produktit parashikojnë ndalesa për shitjen e produktit në treg nën emrin Asiago.

Burimi: https://www.asiagocheese.it/uploads/files_pagina_190920171437_Disciplinare-di-produzione_EN.pdf

Kutia 8. Shembull i provave për PDO-në Italiane - Parma Ham (Parma Proshutë)

SEKSIONI D

PROVA TË ORIGINËS SË PRODUKTIT BRENDA ZONËS GJEORAFIKE

HYRJE

(Etj.)...Kjo seri e marrëdhënieve është përhapur dhe evoluar me kalimin e historisë dhe njerëzve dhe vendeve që i kanë krijuar ato. Për këtë arsye, përshkrimi historik, kulturor dhe legjislativ i lindjes dhe historisë së një produkti ushqimor është mënyra më e mirë dhe mbase mënyra e vetme për të ilustruar tiparet e tij dalluese.

Treguesi i elementeve që provon se produkti e ka origjinën nga zona gjeografike që referohet në emërtimin e tij duhet domosdoshmërisht të përfshij të gjitha elementet që kanë të bëjnë me zonën ashtu siç është parashikuar në Seksionin C më sipër. Konkretisht:

- Parma Ham sigurisht që e ka origjinën nga zona gjeografike që referohet në Seksionin C më sipër, ndërsa karakteristikat e tij janë kryesisht për shkak të mjedisit gjeografik, përfshi faktorët relevant natyror dhe njerëzor. Për më tepër, siç është theksuar në pikën C.2, përpunimi i tij ndodh ekskluzivisht brenda zonës së përcaktuar gjeografike;

- Njëkohësisht, lënda e parë që përdoret për përpunimin e proshutës Parma Ham e ka origjinën nga zona e përcaktuar gjeografike të theksuar në Seksionin C, ku ndodh edhe prodhimi, ndërsa karakteristikat e tij janë për shkak të mjedisit, përfshi faktorët relevant natyror dhe njerëzor.

HISTORIA E DERRIT TË LUGINËS (ang. VALLEY PIG)

Derri është një kafshë omnivore (që ha edhe mish edhe kullotë) që është i lehtë për të ushqyer dhe relativisht lehtë për të zbutur. Prandaj, tranzicioni i tij nga derri i egër në kafshë shtëpiake ka ndodhur shpeshherë dhe në shumë zona, duke filluar nga raca të llojllojshme të derrave e deri në nën-raca. Prandaj çdo "rajon kulturor" e ka "derrin e tij", Po Valley nuk është përjashtim nga kjo.

Për shekuj me radhë dhe në çdo rajon ose zonë kulturore, derri është zbutur vetëm në mënyrë të pjesshme. Vetëm kohëve të fundit, derri është shndërruar në "derr shtëpiak të vërtetë", që nënkupton se është plotësisht i varur nga njerëzit. Kohët e fundit, kjo varësi është vënë në pah nëpërmjet teknikave të kultivimit të përmirësuar që kanë shpjerë në një kafshë të ashtuquajtur "derri teknologjik" ose "derri industrial".

(Etj.)

4.5 Përshkrimi i metodës së fitimit të produktit

Përshkrimi i produktit duhet të bëhet duke konsideruar tërë procesin e furnizimit për sa i përket metodave të përpunimit (për produktet e përpunuara), për të gjitha fazat që ndodhin në territorin në fjalë, ndërsa përshkrimi duhet të përfshijë:

- Përbërësit dhe lëndën e parë;
- Proceset e prodhimit, teknikat dhe kriteret teknike;
- Për produktet shtazore: speciet, praktikat e mbarështimit, moshën në thertore, etj.;
- Për prodhimet bimore: varietetet, vjelja (metoda dhe periudha kohore), magazinimi, etj.;
- Karakteristikat fizike (forma, dukja, etj.) dhe prezantimi (të freskët, të konservuar, etj.); kimike (aditivët, etj.);
- Mikrobiologjik (përdorimi i fermenteve, prania e mikrobeve, etj.);
- Organoleptik (aroma, struktura, ngjyra, profili sensor, shija, etj.).

Për të siguruar këtë definicion, mund të përdoren mjete të llojllojshme plotësuese: hulumtim të lutaturës, intervista me banorët tjerë (në veçanti të moshuarit), si dhe me specialistë që kryejnë analiza fiziokimike, etj. Kutitë e mëposhtme 8 dhe 9 tregojnë disa shembuj sesi mund të përshkruhen metodat e prodhimit në specifikacionet e produktit.



Kutia 9. Djathi Asiago: metoda e prodhimit

SPECIFIKACIONI I PRODUKTIT PDO "ASIAGO"

(Dekret ministror 03/08/2006 Gazeta Zyrtare nr. 190, 17/08/06)

Neni 5 Metoda e Prodimit

Djathi "Asiago", edhe sipas tipit të shtypur edhe sipas tipit të kultivuar, prodhohet nga qumështi dhe në pajtim me rregullativën. Mirëpo, prodhimi i djathit të kultivuar "Asiago" në kasolle lejohet gjatë periudhës së kullotave. Pavarësisht nga rregullativa shëndetësore në fuqi, qumështi duhet të ruhet në temperaturë ndërmjet 4 dhe 11 gradë celsius dhe duhet të përpunohet brenda maksimum 60 orëve nga mjelja e parë ose e dytë. Në ato raste kur djathi "Asiago" prodhohet me qumësht të papërpunuar, transformimi duhet të fitohet brenda 36-48 orëve në fabrikë, sipas dispozitave ekzistuese.

Për prodhimin e djathit të shtypur "Asiago", mund të përdoret qumështi që është fituar nga mjelja e parë ose e dytë, të papërpunuar ose të pasterizuar në 72 gradë celsius për 15 sekonda, sipas dispozitave aktuale.

Për prodhimin e djathit të kultivuar "Asiago", mund të përdoret qumështi i dy mjeljeve, pjesërisht i skremuar për të veçuar kremin, ose nga dy mjelje, pjesërisht të skremuar, ose nga një mjelje e vetme edhe atë pjesërisht të skremuar.

Mund të jetë qumësht i papërpunuar dhe termik deri në 57/68 gradë celsius për 15 sekonda me parametër pozitiv të analizës së fosfatit. Nuk lejohen trajtime të tjera plotësuese të qumështit përveç atyre që janë përcaktuar qartësisht në këtë specifikacion. Për prodhimin e djathit PDO Asiago *që e mbajnë emrin* "prodhime malore", lejohet përdorimi i qumështit nga 2 ose 4 mjelje, mirëpo përpunimi i qumështit duhet të ndodh brenda 18 orëve nga pranimi i tij; në rastin e përdorjes së qumështit nga 2 mjelje, brenda 24 orëve nga pranimi i tij në rastin e përdorimit të qumështit nga 4 mjelje.

Prodhimi i qumështit për prodhimin e djathit të shtypur "Asiago" duhet të jetë qumësht i plotë, ndërsa mikstura në bojler është qumësht, acid laktik ose nxitës, farë djathi prej gjedhi dhe mundësisht sasi të vogla të kloridit sodiumi. Gjatë përpunimit, për kërkesat teknologjike, mund të shtohet edhe një sasi e ujit të pijshëm.

Në rastin e prodhimit të djathit të kultivuar "Asiago", qumështi që përdoret për përpunim është pjesërisht i skremuar, mundësisht me shtim të lizozimës (E 1105) brenda kufirit të lejuar, pastaj mikstura formohet nga qumështi pjesërisht i skremuar, acidi laktik ose nxitësi (starter), fara e djathit të gjedhit, pak sasi të kloridit sodiumit dhe lizozimës. (Etj) ... Qumështi për përpunimin e djathit Asiago duhet të burojë nga një ose dy mjelje. Qumështi për transformimin e Asiagos së kultivuar duhet të burojë nga dy mjelje, pjesërisht të skremuar, nga dy mjelje, nga të cilat njëra është e skremuar, ose nga një mjelje e vetme, pjesërisht e skremuar.

Gjatë përpunimit të djathit të shtypur "Asiago", duhet të plotësohen parametrat teknologjik si në vijim:

- Temperatura e koagulimit 35/40 ° C
- Prerja e gjizës për 15/25 minuta duke shtuar farë djathi në madhësi të një lajthie/arre;
- Temeperatura e gjysmë pjekjes: 44 ° + / - 2 ° C;
- Presimi/shtypja deri në 12 orë;

(Etj.)

Burimi: https://www.asiagheese.it/uploads/files_pagina_190920171437_Disciplinare-di-produzione_EN.pdf

Kutia 10. Vaj Ulliri 'Toscano': shembull i metodës së prodhimit

**SPECIFIKACIONET E PRODHIMIT TË VAJIT TË ULLIRIT EXTRA VIRGIN "TOSCANO",
TREGUESIT GJEORAFIK I MBROJTUR**

Neni 5: Mënyrat e bërjes së vajit

1) Zona e ekstraktimit të vajit të ullirit extra virgin me status të fituar të Treguesit Gjeografik të Mbrojtur "Toscano" përfshin tërë territorin që administrohet nga Rajoni Tuscany.

1a) Zona e ekstraktimit të vajit të ullit extra virgin me status të fituar të Treguesit Gjeografik të Mbrojtur "Toscano" e Seggianos përfshin territorin administrativ të zonës së listuar në paragrafin 2, seksioni 3 i Provincës Grosseto.

1b) Zona e ekstraktimit të vajit të ullirit extra virgin me status të fituar të Treguesit Gjeografik të Mbrojtur "Toscano" e Colline Lucchesi përfshin tërë territorin e zonës së listuar në paragrafin 3, seksioni 3.

Etj.

2) Në Rajonin Tuscany, pas konsultimit me Konsorciumin, lejohen veprimet e mësipërme të ekstraktimit të vajit edhe në objektet që gjenden pranë territoreve të listuara në nën-seksionet e mëhershme 1a), 1b) 1c), 1d), 1e), 1f), 1d), 1h), me kusht që të jenë në territorin administrativ të Rajonit Tuscany.

3) Vjelja e ullinjve për prodhimin e vajit të ullirit extra virgin me status të fituar të Treguesit Gjeografik të Mbrojtur "Toscano" kryhet drejtpërdrejtë nga punëtorja me vegla mekanike ose duke i këputur/mbledhur.

4) Ullinjtë për prodhimin e vajit të ullirit extra virgin me status të fituar të Treguesit Gjeografik të Mbrojtur (seksioni 1) duhet të lahen në temperaturë dhome, çfarëdo trajtimi tjetër është i ndaluar.

5) Për ekstraktimin e vajit të ullirit extra virgin siç përshkruhet në seksionin 1, lejohet vetëm proçsi mekanik dhe fizik për të siguruar arritjen e vajrave pa ndryshimin e tipareve cilësore të frutit.

6) Pronarët e tufave të ullinjve që duhet të analizohen (analiza fizike-kimike dhe organoleptike) për përdorimin e Treguesit Gjeografik të Mbrojtur duhet të zbatohen për certifikimin e produktit të tyre.

7) Rajoni Tuscany ka themeluar një regjistër të objekteve të përpunimit të autorizuar për përpunim të ullinjve për prodhim të vajit (seksioni 1), si dhe i ka përcaktuar zonat e aktivitetit që referohen tek pikat gjeografike.

8) Objektet e përpunimit, anëtarët e regjistrin rajonal dhe të autorizuarit për prodhimin e vajit (sek.1) duhet t'iu përmbahen rregullave për të mirëmbajtur karakteristikat e frutit dhe të ruajnë cilësinë më të mirë organoleptike të produktit. Për më tepër, ato duhet të respektojnë rregullat e prodhimit të përcaktuar për Rajonin Tuscany sipas propozimit të Konsorciumit.

9) Sipas korrespondimit të parametrave të përcaktuar, Rajoni Tuscany, çdo vit, e përditëson regjistrin e objekteve të përpunimit dhe paketimit.

Burimi: <https://www.oliotoscanoigp.it/cms/doc/DisciplinareOlioToscanoIGPEN.pdf>



4.6 Përmendja e organit për kontroll të cilësisë

Specifikacioni i produktit duhet të përfshijë emrin dhe adresën e autoriteteve, nëse ekzistojnë, emrin dhe adresën e organeve të verifikimit të pajtueshmërisë me dispozitat e specifikacionit të produktit në përputhje me Nenin 37 të Rregullativës 1151/2012, si dhe detyrat e tyre konkrete.

Në qoftë se autoritet publike bëjnë kontrolle verifikimi, atëherë ato duhet të garantojnë paanësinë dhe objektivitetin dhe të kenë të punësuar personel të kualifikuar dhe burime të nevojshme për të kryer detyrat e caktuara.

Të gjithë operatorët e GI-ve duhet të kenë sistem të kontrolleve zyrtare. Shtete do të sigurojnë që çdo operator që e respekton Rregullativën të ketë të drejtë të ketë sistem të kontrolleve zyrtare. Lista e organeve të ngarkuar për kontrollet do të publikohet, si dhe periodikisht do të përditësohet nga Komisioni.

Kostoja e verifikimit të pajtueshmërisë me specifikacionet, në lidhje me treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinave lidhur me një zonë gjeografike brenda një komuniteti, do të jetë në kurriz të operatorëve që iu nënshtrihen atyre kontrolleve.

Organet e certifikimit të produkteve duhet të akreditohen në përputhshmëri me Standardin Evropian ISO/IEC 17065 (Vlerësimi i përputhshmërisë — Kushtet për trupat që certifikojnë produkte, përpunime dhe shërbime).

4.7 Rregulla konkrete lidhur me etiketimin e shkurtimeve PDO/PGI

Siguron çfarëdo rregulli konkret të etiketimit dhe paketimit të produktit bujqësor dhe artikullit ushqimor në fjalë.

„Paketimi“ paraqet çdo aktivitet që ndodh pasi që produkti, me emrin e fituar, është krijuar në formën e tij fundore; nuk vlen për ‘thertoret’ e mishit, as për ‘vjeljet’ dhe ‘larjen’ e kulturave. Produkti duhet të jetë i paketuar në diçka të përshtatshme për t’u transportuar dhe shitur. Ky është një kusht për prodhuesit për të paketuar produktin në qese të caktuar të peshës së caktuar.

Kufizimet ndaj prerjes në feta, futjes në shishe, grirjes, etj. ose paketimit mund të përfshihen vetëm me kërkesë të Grupit të Aplikantëve. Kërkesa të tilla nuk duhet të inkurajohen sepse ato e kufizojnë lirinë për të ofruar shërbime në tregun e brendshëm dhe mund të ndikojnë në mënyrë diskriminuese ndaj prodhuesve të vegjël, të cilët nuk kanë qasje në objekte paketimi, por dëshirojnë të shesin me shumicë.

Kutia 11. Rregullat konkrete lidhur me etiketimin

**SPECIFIKACIONET E PRODHIMIT TË VAJIT TË ULLIRIT "TOSCANO" EXTRA VIRGIN,
TREGUESI GJEOGRAFIK I MBROJTUR**

Neni 7. Përshkrimi dhe Prezantimi

1) Është e ndaluar t'i shtohet etiketë produktit 'Toscano' me status Tregues Gjeografik i Mbrojtur; çfarëdo përshkrimi që nuk është siguruar në këtë dokument të specifikacionit të produktit, përfshi dhe mbiemrat si p.sh. "i mirë", "i zgjedhur", "i selektuar", "superior". Mund të përfshihen referenca të vërteta dhe të dokumentuara, me kusht që ato ta paraqesin punën e prodhuesve individual, si p.sh. "varietal", "mbledhur me dorë", etj. E cila gjë është autorizuar paraprakisht nga Konsorciumi.

2) Mund të përdorni emra të vërtetë, emra kompanish, brande private; ato nuk guxon të kenë kuptim lavdërues dhe nuk guxon ta hutojnë konsumatorin.

3) Përdorimi i emrave të kompanisë, pronave, fermave dhe lokacionit të tyre gjeografik, si dhe referenca e paketimit në fermën e ullinjve ose në shoqatën e fermave të ullinjve ose në industrinë e zonës së prodhimit lejohet vetëm nëse produkti është fituar me ullinj të mbledhur në ullishten e kompanisë, si dhe nëse paketimi ka ndodhur në vetë kompaninë.

4) Veprimtaria e paketimit të ullinjve extra virgin me status Tregues Gjeografik të Mbrojtur në bazë të Seksionit 1 duhet të ndodh në Rajonin Tuscany.

5) Çdo tregues gjeografik plotësues, siç është autorizuar nga Seksioni 1 i këtij specifikacioni, duhet të përmendet në etiketë me madhësi të shkronjave jo më të madhe se sa shkronjat që tregojnë për Treguesin Gjeografik të Mbrojtur "Toscano".

6) Përdorimi i treguesve tjerë gjeografik lidhur me rajonet, fshatrat, pronat dhe fermat tjera, nga të cilat në fakt vijnë ullinjët, duhet të shkruhet me germa me madhësi gjysmë të vogla se sa ato germa që e përshkruajnë P.G.I. "Toscano".

7) Emri i Treguesit Gjeografik të Mbrojtur "Toscano" patjetër duhet të duket në etiketë me germa të qarta dhe të pashlyeshme, në mënyrë që mund të dallohet nga treguesit e ndërlikuar që mund të paraqiten në etiketë.

8) Prodhuesi i shisheve duhet ta depozitojë draftin e etiketës për miratim para Konsorciumit. Konsorciumi duhet të përgjigjet brenda 30 ditëve lidhur me ndonjë ndryshim që duhet të bëhet.

9) Emërtimi duhet t'i përmbahet rregullave të etiketimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

10) Vaji u Ullirit Extra Virgin me status të fituar të Treguesit Gjeografik të Mbrojtur "Toscano" duhet të lëshohet në treg për konsumim në konteinerë të përshtatshëm, me kapacitet jo më shumë se 10 litra.

11) Vaji u Ullirit Extra Virgin me status të fituar të Treguesit Gjeografik të Mbrojtur "Toscano" i shoqëruar me një nga treguesit gjeografik plotësues të listuar në Seksionin 1 duhet të lëshohet në treg për konsumim në konteinerë të përshtatshëm, me kapacitet jo më shumë se 5 litra.

12) Është e detyrueshme të theksohet në etiketë viti i prodhimit të ullinjve, nga të cilat është prodhuar vaji i ullirit.

Burimi: <https://www.oliotoscanoigp.it/cms/doc/DisciplinareOlioToscanoIGPEn.pdf>

4.8 Rregullativat dhe kushtet në pajtueshmëri me dispozitat kombëtare/të BE-së

Në këtë pjesë, BE-ja rekomandon të përshkruhet çdo kërkesë plotësuese sipas ligjeve kombëtare që ndikojnë në prodhimin dhe marketingun e produktit, të cilat nuk janë përshkruar më sipër.



5. DOKUMENTI I VETËM

Pikët e përgjithshme:

Dokumenti i Vetëm për dorëzimin e aplikacionit për regjistrim të një emërtimi të mbrojtur të origjinës ose një treguesi gjeografik të mbrojtur duhet të identifikojë produktin duke shfrytëzuar definicionet dhe standardet që përdoren zakonisht për atë produkt.

Përshkrimi duhet të përqendrohet në specifikën e produktit që e mban emrin për t'u regjistruar, duke përdorur njësi matëse, si dhe nocione të zakonshme dhe teknike për krahasime, pa mos përfshi tiparet teknike të qenësishëm të produkteve të atij tipi, si dhe kushtet përkatëse të domosdoshme të aplikueshme për të gjitha produktet e atij tipi.

Dokumenti i Vetëm është i mjaftueshëm në vete. Mos bëni referime të shtojcave, legjislacionit dhe rregullave kombëtare, legjislacionit të BE-së, specifikacionit ose ndonjë dokumenti tjetër. Mos siguroni një bibliografi të gjere e gjatë. Dokumenti i Vetëm nuk duhet të jetë shumë i gjatë (maksimum 3 deri 5 faqe dhe jo më shumë se 2500 fjalë, përveç në rastet e arsyetuara siç duhet), mirëpo duhet të jetë i përpiktë dhe konkret.

Ju lutemi shmangni përshkrimet subjektive dhe jo të përpikta si p.sh., 'i shijshëm', 'perfekt', 'i bukur', 'e preferuara e shtëpiakes', etj., si dhe shmangni mbiemrat sipëror dhe ekzagjerimeve: 'më i miri', 'më i kërkuari', etj.

Gjatë plotësimit të Dokumentit të Vetëm, ju lutemi përdoreni shabllonin (i qasshëm në të gjitha gjuhët e BE-së) në faqen e internetit të Komisionit. Shabllonet e kanë formatin e duhur për publikim në Gazetën Zyrtare të BE-së (OJ), në qoftë se aplikacioni juaj është i suksesshëm.

Lidhur me përmbajtjen, ju lutemi referohuni Dokumentit të Vetëm që tashmë është i miratuar nga Komisioni dhe është i publikuar në OJ (i qasshëm në bazën e të dhënave DOOR)¹⁵.

Në rast se duhet të bëni ndryshime, grupet e prodhuesve që janë ndryshe nga ai që e ka dorëzuar aplikacionin fillestar, po ashtu mund të dorëzojnë aplikacione për ndryshime. Mirëpo, këto prodhues duhet të punojnë me produktin e emërtuar në ndryshimet.

¹⁵ Faqja e internetit për shabllonet: http://ec.europa.eu/agriculture/quality/schemes/legislation/index_en.htm

Kutia 12: Dokumenti i Vetëm: pikat kryesore

DOKUMENTI I VETËM '...'	
BE Nr: PDO ()	PGI ()
EMRI (EMRAT)	
<p>PIKA KRYESORE: Emri duhet të përdoret për të emërtuar një produkt konkret. Emrat e shpikur nuk pranohen. Emrat që përshkruajnë një produkt të përgjithshëm dhe që nuk i referohen produktit konkret nuk do të pranohen.</p> <p>Prova e përdorimit: emri duhet të jetë në përdorim në treg ose në gjuhën e zakonshme për të emërtuar produktin konkret para se të bëhet aplikacioni. Do të ishte e dobishme të përfshihen elemente që e përshkruajnë përdorimin komercial ose gjuhësor.</p> <p>Gjuha dhe dorëshkrimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emri duhet të shkruhet në gjuhën që përdoret në rajonin e origjinës, e cila mund të jetë gjuhë kombëtare ose një gjuhë më pak e përdorur ose një dialekt ose një gjuhë që historikisht përdoret në atë rajon për të përshkruar produktin; - Nëse emri shkruhet në alfabetin latin, atëherë siguroni transkriptim latin të emrit. Vini re se 'transkriptimi' nuk është as përkthim as transliterim: transkriptimi në alfabetin latin (përafërsisht) e jep tingullin e njëjtë të fjalëve në dorëshkrimin origjinal. <p>Nëse përdoren më shumë emra për një produkt (p.sh., atje ku përdoren gjuhë kombëtare dhe rajonale):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aplikanti mund të zgjedh të regjistrojë njërin ose të gjitha emrat; - emrat duhet të ndahen me '/'; (mos përdorni 'ose'): 'Lorem-Ipsum' / 'Lorus-Ipsus' - Nëse emrat, në fakt, i referohen produkteve të ndryshme, atëherë dorëzoni një aplikacion të veçantë për çdo produkt me emër të ndryshëm. Çdo herë kur do të citohet si i tillë, ky emër i dyfishtë duhet të përsëritet. Teksti mund të bëhet më i lexueshëm duke përdorur nocione si 'djathi' dhe 'molla' atje ku kuptimi është i qartë. <p>Nëse një emër mbulon më tepër se një produkt të dallueshëm (p.sh. forma e papërpunuar dhe forma e gatshme e produktit) atëherë emri duhet të përdoret për të emërtuar secilën formë të produktit. Të dy produktet duhet të përshkruhen dhe duhet të përmbushen të gjitha kushtet e regjistrimit për të dy produktet, p.sh. peshk i papërgatitur dhe peshk i përgatitur. Nëse të gjitha kushtet e regjistrimit përmbushen, atëherë një aplikacion është i mjaftueshëm.</p> <p>Jini të përpiktë: emri duhet të jetë tamam njësoj (fjalë njësoj, germa njësoj) në të gjitha rastet përgjatë tekstit të Dokumentit të Vetëm.</p> <p>Duhet të sigurohet një justifikim në rast se një emër i referohet ose e përfshin emrin e një shteti.</p> <p>Nëse përdorni një emër që përfshin emrat e varieteteve ose racave, ju lutemi siguroni prova se përmbushen kushtet e përcaktuara në Nenin 42 të Rregullativës (BE) Nr. 1151/2012.</p>	
VENDET ANËTARE OSE VENDET E TRETA	
<p>Përmendeni shtetin në të cilin prodhohet produkti. Nëse janë të përfshirë më tepër se një shtet, përkatësisht atje ku zona gjeografike përshkon kufirin, listoni të gjitha shtetet.</p>	



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT BUJQËSOR OSE ARTIKUJVE USHQIMOR

3.1. Lloji i produktit

Shfrytëzoheni klasifikimin e produkteve në Shtojcën XI të Rregullativës (BE) Nr. 668/2014 (pjesa 2.5)

3.2. Përshkrimi i produktit emri i të cilit vlen për pikën (1)

PIKA KRYESORE: Produkti duhet të jetë konkret/specifik: nuk mund të jetë një produkt gjenerik, pa karakteristika që e dallojnë nga të tjerët. Pyeteni veten: Çfarë e bën të veçantë këtë produkt?

Në çfarë mënyra është ndryshe nga një produkt tjetër i kategorisë së njëjtë? Nuk këmbëngulim në produkte unike, mirpo nëse nuk ka asgjë që e dallon produktin nga një produkt tjetër, atëherë ai nuk mund të pranohet si PDO ose PGI.

Ju lutemi, fillojeni përshkrimin me llojin detajor të produktit, edhe nëse duket që përsëritet në origjinalin. Një mënyrë e mirë për të filluar është: 'MollaLorem-Ipsum' është molë e varietetit të...> Në Gazetën Zyrtare, emri 'Molla Lorem-Ipsum' nuk do të përkthehet, duke i mundësuar lexuesit të shikoj menjëherë, në gjuhën e tij, se çfarë përbën ai produkt: 'La 'Lorem-Ipsum apple' est une pomme ...'

PIKA KRYESORE: Përshkrimi duhet të ofrojë të dhëna teknike, shkencore për të përshkruar produktin konkret. Përfshini të dhënat konkrete fizike, mikrobiologjike, kimike dhe organoleptike të produktit. Nëse këto të dhëna janë të qenësishme për produktin, varietetin ose racën të cilit i përket produkti, atëherë këto të dhëna nuk duhet të përfshihen. Përdorni përpikëri dhe gjuhën që do ta përdorte një shkencëtar agronom ose teknolog ushqimor për të përshkruar produktin. Përdorni definicionet dhe standardet që zakonisht përdoren për atë produkt. Përdorni njësi matjeje që zakonisht përdoren, të jenë komparative dhe të kenë elemente teknike.

PIKA KRYESORE: Kjo pjesë duhet të jetë konzistente me Seksionin 5 lidhur me specifikat e produktit. Për produktet e bagëtive të ushqyer me kullota, duhet të përmendet periudha minimale e kullotjes (muaj ose periudha totale vjetore).

3.3. Ushqimi për kafshët (vetëm për produktet e origjinës shtazore) dhe lënda e parë (vetëm për produktet e përpunuara)

Për produktet e papërpunuara, lëreni këtë pjesë të zbrazur.

Për PDO-të: të gjitha ushqimet për kafshët duhet të funizohen brenda zonës gjeografike (Neni 5(1)(c) i Rregullativës (BE) Nr. 1151/2012). Prandaj, ju lutemi siguroni konfirmim që të gjitha ushqimet për kafshët janë furnizuar brenda asaj zone.

Mirëpo, nëse kjo teknikisht nuk është e mundur, atëherë derogimi (anashkalimi) lejohet (Neni 1 i Rregullativës së Deleguar të Komisionit (BE) Nr. 664/2014). Në bazë të këtij Neni, mund të shtohet ushqimi i kafshëve i furnizuar jashtë asaj zone, me kusht që cilësia e produktit ose karakteristikat e tij për shkak të mjedisit tjetër gjeografik të mos ndikohen nga ajo. Për më tepër, Ushqimi i shtuar në asnjë mënyrë nuk guxon të tejkalojë 50 % (të materies së thatë në bazë vjetore) të ushqimit total. Në qoftë se duhet të shtohet ushqim nga jashta zonës në ushqimin e kafshëve, ju lutemi siguroni përshkrim të shkurtër të këtyre përjashtimeve dhe justifikoni ato në pajtim me Nenin 1 të Rregullativës së Deleguar të Komisionit (BE) Nr. 664/2014. Specifikoni përqindjen e ushqimit (materien e thatë në bazë vjetore) e furnizuar jashtë zonës gjeografike, shpjegoni pse nuk është e mundur q 100% e ushqimit të sigurohet brenda zonës gjeografike, si dhe demonstroi që cilësia e produktit ose karakteristikat e tij për shkak të mjedisit tjetër gjeografik nuk ndikohen nga ajo.

E gjithë lënda e parë duhet të sigurohet brenda zonës gjeografike (Neni 5(1)(c) i Rregullativës (BE) Nr. 1151/2012). Prandaj, ju lutemi siguroni konfirmim që e gjithë lënda e parë është furnizuar brenda asaj zone.

Nëse duhet të shfrytëzohet lëndë e parë jashtë zonës, atëherë ju lutemi siguroni përshkrim të hollësishëm të këtyre përjashtimeve dhe justifikoni ato në pajtim me Nenin 5(3) të Rregullativës (BE) Nr. 1151/2012.

Theksoni ushqimin dhe lëndën e parë që shfrytëzohet, si dhe çfarëdo kushtesh tjera cilësore, siç janë: grada, klasi i karkasës, varieteti ose raca, përmbajtja e yndyrave, etj.

Për PGI-të:

Përshkruani dhe justifikoni çdo kufizim lidhur me furnizimin e lëndës së parë, pasi që ato mund të paraqesin pengesa për tregun e vetëm. Ato duhet të justifikohen sa i përket lidhjes (p.sh., kriterin cilësor lidhur me specifikën e produktit). Është e vështirë të justifikohen kufizimet e furnizimit kombëtar të lëndës së parë. Kufizimet mbi furnizimin e lëndës së parë në zonën gjeografike mund të jenë të justifikueshme.

Theksoni lëndën e parë që shfrytëzohet, si dhe çfarëdo kushtesh tjera cilësore, siç janë: grada, klasi i karkasës, varieteti ose raca, përmbajtja e yndyrave, etj.

3.4. Hapat konkret që duhet të ndodhin në procesin e prodhimit në zonën e identifikuar gjeografike

Për PDO-të:

Të gjitha hapat e prodhimit duhet të ndodhin brenda zonës gjeografike (Neni 5(1)(c) i Rregullativës (BE) Nr.1151/2012). Prandaj, ju lutemi konfirmoni se të gjitha hapat ndodhin në atë zonë.

Përjashtimi i vetëm i mundshëm ka të bëjë me lëndën e parë (shih seksionin 3.3). Në disa rrethana mirë të justifikuara, për emërtimet e njohura në vendin e origjinës para 1 majit të vitit 2004, lënda e parë mund të furnizohet nga një zonë gjeografike më e madhe ose e ndryshme (Neni 5(3) i Rregullativës (BE) Nr. 1151/2012). Në këtë rast, hapat e prodhimit mund që legalisht të ndodhin jashtë zonës së identifikuar gjeografike. Përshkrimi dhe justifikimi për këtë derogim duhet të përfshihet në seksionin 3.3, dhe prandaj mjafton një referencë e thjeshtë për këtë seksion.

Për PGI-të:

Së paku një hap i prodhimit duhet të ndodh brenda zonës gjeografike (Neni 5(2)(c) i Rregullativës (BE) Nr. 1151/2012).

Pa mos hyrë në shumë hollësi, listoni të gjitha hapat, që nga furnizimi i lëndës së parë e deri në produktin fundor, e cila gjë duhet të ndodh brenda zonës gjeografike. Për shembull, për mishin, faza e therjes dhe prerjes është pjesë e procesit të prodhimit. Prerja në feta, grirja, paketimi nuk janë pesë e procesit të prodhimit dhe duhet të përshkruhen në seksionin 3.6.

Ju lutemi përshkruani dhe justifikoni kufizimet dhe derogimet; nëse kufizimet kanë të bëjnë me rastet e mbuluara në seksionin 3.3, atëherë përmendni një referencë të thjeshtë të këtij seksioni.

3.5. Rregullat konkrete lidhur me, prerjen në feta, grirjen, paketimin, etj. të produktit të cilit i referohet emri i regjistruar

Kjo pjesë është opsionale. Theksoni çfarëdo rregulle dhe kufizimesh lidhur me këto aktivitete; përkatësisht hapat që ndodhur pas prodhimit të produktit fundor dhe ofroni justifikimin e tyre.

PIKA KRYESORE: Çdo kufizim gjeografik duhet të mbështetet me një justifikim të fortë e specifik të produktit.

Ndalimi i paketimit jashtë zonës duhet të jetë një përjashtim, pasi që kjo paraqet kufizim të lirive të Tregut të Vetëm. Bëjeni të qartë nëse kufizimet e parandalojnë blerësin (p.sh. një Supermarket në një Vend tjetër Anëtar) të bëjë ri-paketimin ose prerjen në feta, etj. të produktit dhe ofroni justifikim për ato kufizime.



3.6 Rregullat specifike lidhur me etiketimin e produktit të cilit i referohet emri i regjistruar

Kjo pikë është opsionale. Mund të theksoni këtu çdo kërkesë të caktuar etiketimi, siç është logoja e produktit që duhet të paraqitet në etiketën e produktit. Një logo në bardhë e zi mund të riprodhohet në Dokumentin e Vetëm. Kjo mund të jetë e dobishme për inspektorët e Vendeve Anëtare për të respektuar të drejtat tuaja. Nëse duhet të riprodhohet logoja në etiketë, atëherë ajo duhet të jetë e qasshme për të gjithë prodhuesit.

Mos i përsëritni etiketimet që i kërkojnë rregullat kombëtare ose të BE-së: këto rregulla vlejnë pa dallim nëse bëni regjistrim për PDO ose PGI dhe nëse ndryshohen rregullat, prodhuesit PDO/PGI mund të parashtrajnë amandamente.

Nuk është e domosdoshme të përfshini etiketim opsional.

DEFINIMI I PËRPIKTË I ZONËS GJEOGRAFIKE

Jini të përpiktë. Në specifikacion, përshkruani zonën gjeografike duke iu referuar, sa më shumë që është e mundur, kufijve fizik (p.sh. lumejve, rrugëve) ose kufijve administrativ. Duhet të jetë e qartë për një fermer dhe për inspektorët në qoftë se çdo fushë individuale është brenda ose jashtë zonës. Shmangni nocionet e përgjithshme.

Në Dokumentin e Vetëm, nëse zona përbëhet nga 50 qarqe/rajone brenda një province me 55 qarqe/rajone, mos i listoni të gjithë 50 rajonet, por theksoni: 'Provinca e Lorem-Ipsum, me përjashtim të qarqeve/rajoneve Dolor, Sit, Amet, Magna dhe Adipisicing.'

PIKA KRYESORE: Zona gjeografike duhet të përcaktohet sa i përket lidhjes ndërmjet vendit dhe produktit.

- Theksoni nëse rajoni është i kufizuar me zona të caktuara (p.sh. pellg peshku) ose lloje të dheut brenda rajonit. Parapëlqehet një rajon homogjen dhe i vazhdueshëm, po ashtu edhe karakteristikat e mjedisit, e cila gjë është thelbësore për të provuar lidhjen.

Ju rekomandojmë të përfshini një hartë të rajonit.

LIDHJA ME ZONËN GJEOGRAFIKE

PIKA KRYESORE: Lidhja me zonën gjeografike është pjesë thelbësore e Dokumentit të Vetëm.

Ajo duhet të demonstrojë në çfarë mënyre karakteristikat e produktit janë të tilla për shkak të zonës gjeografike dhe cilat janë elementet natyrore, njerëzore ose të tjera që e bëjnë këtë produkt më specifik.

Kjo pjesë duhet të përshkruajë specifikat e produktit dhe të zonës gjeografike, të cilat i prodhojnë ose ndikojnë mbi këto faktorë, si dhe si janë të ndërlidhur këto dyja. Kjo është 'lidhja' ndërmjet zonës gjeografike dhe cilësisë së produktit.

Përshkrimi duhet po ashtu të theksojë se në çfarë mënyre metodat e prodhimit të produktit janë superiore ndaj të tjerave dhe kontribuojnë në karakterin e tij specifik dhe dallues.

Aplikacioni PGI: Theksoni qartësisht nëse aplikacioni bazohet në një cilësi specifike pse reputacion të caktuar ose në karakteristika tjera që i atribuohen origjinës gjeografike.

Specifikat e produktit

Kjo pjesë duhet të jetë në përputhje me seksionin 3.2., si dhe të shmangen përsëritjet sa më shumë që është e mundur. Identifikoni dhe përshkruani çfarë e bën të veçantë këtë produkt në krahasim me produktet e ngjashme. Theksoni vetëm karakteristikat e veçanta të produktit që shkaktohen nga elementet e përshkruara në seksionin 5.1.

PIKA KRYESORE: Mos përfshini karakteristika të produktit që nuk kanë lidhje me zonën gjeografike ose me njohuritë eksperte të prodhuesve, ose nuk kanë rëndësi për reputacionin e produktit.

Jepni elemente konkrete dhe të përpikta duke i justifikuar këto njohuri eksperte.

Jepni shembuj konkret të përdorimit efektiv të emrit, edhe në të kaluarën edhe në të tashmen, parapëlqehet të përdorni elemente të marra nga marketingu i produktit.

Specifikat e zonës gjeografike:

PIKA KRYESORE: Identifikoni dhe përshkruani karakteristikat e zonës së identifikuar gjeografike të cilat janë relevante për ndërlidhjen. Këtu mund të përfshihen karakteristikat pedo-klimatike; topografia, klima, reshjet e shiut, toka, ekspozimi, lartësia mbidetare, etj. Mos përfshini karakteristika të zonës gjeografike të cilat nuk kanë ndikim mbi specifikën e produktit. Shmagnini përdorimin e terminologjisë së përgjithshme, p.sh. 'peizazh i bukur'.

Këtu mund të përshkruhen edhe njohuritë e prodhuesve lokal. Kjo duhet të jetë një shkathtësi specifike dhe e veçantë – shkathtësitë e zakonshme të prodhimit nuk mjaftojnë.

Si ndikojnë specifikat e zonës gjeografike mbi ato të produktit (lidhja kauzale)

PIKA KRYESORE: Tregoni sesi karakteristikat e produktit janë prodhuar nga faktorët e pranishëm në atë zonë. Jepni arsyetim objektiv të lidhjeve të specifikave të zonës me produktin.

Në rastin e aplikacioneve për PGI duke u bazuar në reputacionin, theksoni këtu arsytet pse produkti specifik është i ndërlidhur me zonën gjeografike.

Theksoni reputacionin specifik dhe siguron informacione dhe elemente të përpikta për të justifikuar atë.

Artikujt e gazetave mund të jenë mënyra më e mirë për të ilustruar këtë ndërlidhje.

Tregoni që reputacioni i produktit është i ndërlidhur me emrin dhe i atribuohet zonës gjeografike. Mund të provoni reputacionin me elemente si p.sh., shpërblime/çmime, referenca të librave profesional ose shtypin, referenca speciale në publikime gastronomie, etj.

Referencat e publikimit të specifikacionit.

Ju lutemi përshkruani dhe justifikoni çdo kufizim dhe derogim; nëse kufizimet kanë të bëjnë me rastet tashmë të përfshira në seksionin 3.3, atëherë shënoni një referencë të thjeshtë në këtë seksion.

6. SPECIALITETE TRADICIONALE TË GARANTUARA (ang. TRADITIONAL SPECIALITY GUARANTEED - TSG)

Specialitetet Tradicionale të Garantuara (TSG) i paraqesin pikëpamjet tradicionale siç janë mënyra se si është përpunuar apo prodhuar produkti ose përbërja e tij pa mos qenë i ndërlidhur me një zonë të caktuar gjeografike. Emri i produktit që duhet të regjistrohet si një TSG e mbron atë kundër falsifikimit dhe keqpërdorimit. Qëllimi konkret i skemës për specialitete tradicionale të garantuara është të ndihmojë prodhuesit e produkteve tradicionale që t'ua përcjellin konsumatorëve atributet e vlerës së shtuar të produktit të tyre.

Skema e Specialiteteve Tradicionale të Garantuara (TSG) është krijuar për të mbrojtur metodat tradicionale të prodhimit dhe recetave duke i ndihmuar prodhuesit e produkteve tradicionale për të futur në treg dhe për t'ua përcjellur konsumatorëve atributet e vlerës së shtuar të recetave dhe produkteve të tyre tradicionale.

Shembull: Gueuze TSG është një birra tradicionale që prodhohet me fermentim spontan. Në përgjithësi, prodhohet në zonën përreth dhe në Bruksel, Belgjikë. Megjithatë, duke pasur statusin e TSG, metoda e tij e prodhimit mbrohet, mirëpo mund të prodhohet diku tjetër.

6.1 Përmbajtja e aplikacionit për regjistrim të TSG-së

Aplikacioni për regjistrimin e emrit si një Specialitet Tradicional i Garantuar duhet të përmbajë:

- emrin dhe adresën e grupit të aplikantëve;
- specifikacionin e produktit;
- Deklaracionin e Vendet Anëtar që konsideron që aplikacionin i depozituar nga grupi kualifikohet dhe i plotëson kushtet e kësaj Rregulloreje, si dhe dispozitat e miratuara në bazë të saj. Nga vendet e treta nevojitet prova e mbrojtjes.

PRODUCT SPECIFICATION OF A TRADITIONAL SPECIALITY GUARANTEED

[Insert name, as in 1 below] "..."
EC No: [for EU use only]
Member State or Third Country "..."

1. NAME(S) TO BE REGISTERED
..."

2. TYPE OF PRODUCT [AS IN ANNEX XI]
....

3. GROUNDS FOR REGISTRATION

3.1. Whether the product:

is from a mode of production, processing or composition corresponding to traditional practice for that product or foodstuff
 is produced from raw materials or ingredients that are those traditionally used.
[Provide explanation]
☒

3.2. Whether the name:

has been traditionally used to refer to the specific product
 describes the traditional character or specific character of the product
[Provide explanation]

4. DESCRIPTION

4.1. Description of the product to which the name under point 1 applies, including its main physical, chemical, microbiological or organoleptic characteristics showing the product's specific character (Article 7(2) of this Regulation)
....

4.2. Description of the production method of the product to which the name under point 1 applies that the producer must follow including, where appropriate, the nature and characteristics of the raw material or ingredients used, and the method by which the product is prepared (Article 7(2) of this Regulation)
....

4.3. Description of the key element establishing the product's traditional character (Article 7(2) of this Regulation)
....

Burimi: Elaborimi i autorit bazuar në udhëzimet zyrtare të BE-së

6.2 Kriteret kryesore për regjistrim të TSG-së

Që të garantohet që emrat e produkteve tradicionale autentike të regjistrohen nën këtë skemë, duhet të përshtaten kriteret dhe kushtet për regjistrim të emrit, në veçanti ato lidhur me përkufizimin e termit 'tradicionale', të cilat duhet të përfshijnë produkte që janë prodhuar për një periudhë më të gjatë kohore (Sipas nenit 36 të Reg. 1151/2012).

Emri do të jetë i kualifikuar të regjistrohet si një specialitet tradicional i garantuar nëse përshkruan një produkt konkret ose artikull ushqimor që:

- ✓ rezulton nga një mënyrë e prodhimit, përpunimit ose një përbërje që korrespondon me një praktikë tradicionale të atij produkti ose artikulli ushqimor; ose
- ✓ është prodhuar nga lënda e parë ose përbërës që përdoren tradicionalisht

Që një emër të regjistrohet si specialitet tradicional i garantuar, ai duhet të jetë përdorur tradicionalisht për t'iu referuar produktit konkret; ose për të identifikuar karakterin tradicional ose karakterin konkret të produktit.

Emri i specialitetit tradicional të garantuar do të regjistrohet sipas dorëshkrimit të tij origjinal. Aty ku dorëshkrimi nuk është me germa latine, atëherë do të regjistrohet me transkriptim me germa latine, së bashku me emrin origjinal.

Nëse demonstron në procedurën e kundërshtimit/ ankesave se emri përdoret edhe në një vend tjetër të tretë ose një Vend Anëtar, që të dallohen produktet e krahasueshme ose produktet që mbajnë emër të ngjashëm ose identik, vendimi për regjistrim i marrë në përputhje me Nenin 52(3) mund të përcaktojë që emri i specialitetit tradicional të garantuar duhet të shoqërohet me pohimin 'i prodhuar sipas traditës së' menjëherë pasuar nga emri i vendit ose rajonit. Prandaj, emri mund të mos regjistrohet nëse i referohet vetëm pohimeve të natyrës së përgjithshme të shfrytëzuar për një grup produktesh ose nëse i referohet pohimeve të përcaktuara nga legjislacioni i veçantë i Unionit.

6.3 Specifikacioni i produktit (TSG)

Që të sigurohet që specialitetet tradicionale të garantuara iu përmbahen specifikacioneve të tyre, prodhuesit e organizuar në grupe duhet vetvetiu të definojnë produktin në specifikacion. Mundësia për të regjistruar një emër si specialitet tradicional i garantuar është e hapur për prodhues të vendeve të treta (sipas nenit 37 të Reg. 1151/2012).

Specifikacioni i produktit për specialitetin tradicional të garantuar duhet të përmbajë:

- emrin e propozuar për regjistrim, në gjuhët e përshtatshme;
- një përshkrim të produktit duke përfshirë edhe karakteristikat e tij kryesore fizike, kimike, mikrobiologjike dhe organoleptike, që e tregojnë karakterin specifik të produktit;

- një përshkrim të metodës së prodhimit, të cilën duhet ta ndjekin prodhuesit, përfshi edhe, aty ku është e përshtatshme, natyrën dhe karakteristikat e lëndës së parë ose përbërësve të përdorur, dhe
- metodën me të cilën është përgatitur produkti; dhe elementet kryesore që e përcaktojnë karakterin tradicional të produktit.

7. SKEMAT SHITESË TË CILËSISË

Komisioni Evropian ka miratuar një Rregullore mbi kushtet opsionale të cilësisë. Këto skema janë formuar për të lehtësuar komunikimin me tregun evropian mbi vlerën e shtuar të produkteve bujqësore që prodhohen në kushte të vështira, siç janë zonat malore ose shumë të largëta.

Termi i cilësisë 'produkt malor'¹⁶ i përcakton specifikat e produktit që prodhohet në zona malore në kushte të vështira natyrore. Duke njohur që kjo është një përparësi për fermerët, si dhe për konsumatorët, pasi që mundëson produkti të futet në treg më mirë, por edhe siguron disa karakteristika të caktuara për konsumatorin.

Specifikacionet: Lënda e parë dhe ushqimi i kafshëve vijnë nga zonat malore. Për produktet e përpunuara, prodhimi po ashtu duhet të ndodhë në ato zona.

Produktet e rajoneve më të largëta të BE-së – Bujqësia në zonat më të largëta të BE-së përballet me vështirësi për shkak të largësisë dhe izolimit, përfshi edhe kushtet e vështira gjeografike dhe meteorologjike. Për të siguruar ndërgjegjësim më të madh të produkteve bujqësore të zonave më të largëta (Departamentet Franceze Tejoqeanike - Guadeloupe, Guiana Franceze, Réunion dhe Martinique – si dhe Ishujt Azore, Madeira dhe Ishujt Kanarie) është krijuar një logo e dedikuar.

Specifikacionet – Produktet ushqimore dhe bujqësore të prodhuara në rajonet më të largëta.

¹⁶ Rregullorja për produktet malore: (RREGULLATIVA E DELEGUAR E KOMISIONIT (BE) Nr 665/2014 e datës 11 mars 2014, rregullativa plotësuese (BE) Nr 1151/2012 e Këshillit dhe Parlamentit Evropian lidhur me kushtet e përdorimit të termit opsional të cilësisë 'produkt malor')



KONKLUZIONET dhe KOMENTET PËRFUNDIMTARE

Në këtë fazë, një ndër hapat më të rëndësishëm për ata që vendosin për të futur sistemin GI është që së pari të përcaktojnë nëse një produkt posedon nivel të mjaftueshëm të dallueshmërisë dhe nëse palët e interesuara/aktorët janë të interesuar të përkushtohen në afat të gjatë ashtu siç kërkojnë kushtet edhe të bashkëpunimit edhe të burimeve.

GI-të duhet të konsiderohen me kujdes dhe të strukturohen me pjesëmarrje të gjërë dhe leadership që të mundësohen përfitimet maksimale për aktorët e llojllojshëm në rajon. Në nivel kombëtar, kjo nënkupton: sigurim të njohjes dhe demarkacionit; përcaktimin e cilësisë ose standarteve të procesit që do të zbatohen; përkrahjen e proceseve asociative në nivel të zinxhirit të furnizimit dhe organizatave; dhe sigurimin e fondeve zhvillimore dhe promovionale për të mbuluar koston themelore, e cila kosto mund të jetë deri në qindra mijëra dollarë para se të shitet ndonjë produkt me status GI (ITC, 2009).

Rëndësia e ushqimeve tradicionale për çdo shtet është relevante sepse prodhimi i ushqimit vendor ndikon në kulturën rajonale, në ruajtjen e biodiversitetit dhe kontribuon në qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale.

Implementimi i skemave të cilësisë së ushqimit mund të sjellë shumë përfitime jo vetëm për prodhuesit, por edhe për konsumatorët dhe komunitetet lokale. Ato krijojnë vlerë të shtuar, e përmirësojnë qasjen në treg, e ruajnë ekspertizën lokale dhe i mbrojnë burimet kombëtare.

Që të arrihen politikat afatgjate dhe të qëndrueshme ushqimore, si dhe që të sigurohet znatimi i suksesshëm i skemave të cilësisë, mund të konsiderohen disa veprime/udhëzime të mundshme në të ardhmen.

1. Të formohet një kornizë institucionale kombëtare (infrastrukturë) dhe sistem efikas për zbatimin e GI-ve në praktikë.

- Shtetet duhet të caktojnë autoritetet që do të jenë përgjegjëse për të ndërmarr hapa të përshtatshëm administrativ dhe juridik në procesin e regjistrimit të produkteve tradicionale.

- Autoritetet duhet të ofrojnë garanci adekuate të objektivitetit dhe paanësisë, si dhe të kenë personel të kualifikuar dhe burime të nevojshme për të realizuar funksionet e tyre.

- *Certification control enforcement*

2. Të mbështetet qasja nga “poshtë-lart” dhe të ngritet ndërgjegjësimi i prodhuesve.

Roli i prodhuesve dhe krijimi i grupeve/organizatave duhet të njihet dhe duhet nxjerr në pah. Grupet luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e aplikimit për regjistrimin. Grupi i prodhuesve duhet të përcaktojë produktin në pajtim me specifikacionin e përpiktë i cili duhet të përfshihet në dokumentin e ashtuq. “specifikacioni i produktit”. Specifikacionet janë një element i rëndësishëm i aplikacionit dhe i sistemit të mbrojtjes. Ato i përmbajnë karakteristikat dhe hollësitë e produktit, procesit të prodhimit dhe origjinës së lëndës së parë që përdoret për prodhim. Prodhuesit duhet të sigurojnë prodhim standard dhe cilësitë të produktit, si dhe mund ta menaxhojnë specifikacionin e produktit si grup.

Grupi mund të zhvillojë aktivitete lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të mbrojtjes së emrave të regjistruar, pajtueshmërinë e prodhimit me specifikacionin e produktit, informimin dhe promovimin e emrit të regjistruar, si dhe në përgjithësi, të çdo aktiviteti që synon përmirësimin e vlerës së emrave të regjistruar dhe efektivitetit të skemave të cilësisë dhe të zhvillimit të strategjive promovionale lokale.

3. Të mbështeten produktet e regjistruara me status GI (ose kandidatëve të mundshëm)

- Të mbështeten grupet e mundshme për të fituar status ligjor (regjistrim të sipërmarrjeve të tyre) me implementimin e derogimeve, si dhe fleksibilitet për fermerët-prodhues të vegjël dhe mbështetje plotësuese nga vetëqeverisja vendore
- Të përmirësohen RDP-të me qëllim forcimin e zbatimit të politikave ushqimore
- Të mbështeten dhe promovohen logot për prodhimet me status PDO dhe PGI.
- Sesione trajnimi në temën e Treguesve Gjeografik dhe kushteve themelore standarde të cilësisë
- Të rritet vizibiliteti i GI-ve në tregun rajonal dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve.

